


Fuqizimi  
**i Grave**  
në Politikë





*Ky botim u mundësua nga:*



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
Prezenca në Shqipëri

### *Shënim*

Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë botim janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën apo qëndrimin zyrtar të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

## Parathënie

Ambasadori Florian Raunig, Kreu i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri

## Intervistat

1. Znj. Mimi Kodheli
2. Znj. Voltana Ademi
3. Znj. Albana Vokshi
4. Znj. Rajmonda Balili
5. Znj. Evis Kushi
6. Znj. Nushe Hoxhaj
7. Znj. Felek Ibrahim
8. Znj. Arjana Pupa
9. Znj. Sanije Batku



## Parathënie

Ky është edicioni i dytë i botimit “Fuqizimi i grave në politikë”, i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri. Ai përmban intervista me disa nga gratë më të shquara në politikën shqiptare, duke përfshirë znj. Mimi Kodheli, ministren e parë shqiptare të Mbrojtjes dhe znj. Voltana Ademi, kryetaren e parë të bashkisë së Shkodrës. Si znj. Kodheli, ashtu edhe znj. Ademi, erdhën në politikë nga karriera të suksesshme profesionale. Dy deputete mjaft të spikatura të Kuvendit të Shqipërisë, znj. Evis Kushi dhe znj. Albana Vokshi, diskutojnë përvojat dhe sfidat e tyre në fushën e barazisë gjinore.

Kryetarja e bashkisë së Patosit, znj. Rajmonda Balili, e cila fitoi mandatin e saj të dytë më 2015, flet rreth arritjeve dhe planeve të saj për të ardhmen. Znj. Nushe Hoxhaj, znj. Felek Ibrahim, znj. Sanije Batku dhe znj. Arjana Pupa, gra të spikatura nga zona të ndryshme të vendit, kontribuuese në qeverisjen lokale, shoqërinë civile dhe jetën politike, flasin për përvojat e tyre lidhur me ndryshimin që Platforma Kombëtare e Gruas solli në jetën e tyre. Platforma Kombëtare është një rrjet jozyrtar, i ngritur më 2010, në kuadër të projektit të Prezencës së OSBE-së “Fuqizimi i grave në politikë”, që mbledh gra nga i gjithë spektri politik dhe nga shoqëria civile.

Ky botim synon të rrisë ndërgjegjësimin në lidhje me rolin e gruas në jetën politike në Shqipëri. Gratë janë kontribuuese dhe faktorë të rëndësishëm; ato duan një jetë më të mirë për veten dhe një të ardhme më të mirë për vendin. Të gjitha gratë e portretizuara në këtë libër janë përballur me sfida dhe vështirësi, si në përpjekjet e tyre për të hyrë në botën e politikës, ashtu edhe gjatë karrierës së tyre politike. Megjithatë, së bashku me sfidat kanë arritur edhe sukseset e jashtëzakonshme. Kjo ka ndodhur në sajë të përkushtimit, këmbënguljes dhe, në shumë raste, edhe të mbështetjes që ato kanë arritur të sigurojnë. Shpresojmë që përvojat e këtyre grave të nxisin

sa më shumë gra që të japin kontribute të vlefshme në përmirësimin e jetës në Shqipëri, në mënyrë që ato të kenë më tepër besim në aftësitë e tyre dhe të kandidojnë në zgjedhjet e ardhshme.

Historitë e këtyre grave ia vlen të lexohen dhe të mbahen mend.

*Ambasadori Florian Raunig*

*Kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri*

## MIMI KODHELI

nga Irena Shabani

Ajo është ministrja e parë femër e mbrojtjes në Shqipëri. E gjatë, me sy të kthjellët dhe përgjigje të sakta. Kështu mund ta përshkruajmë Mimi Kodhelin. Përvoja e saj në politikë ka nisur në vitin 2000 si nënkryetare e bashkisë së Tiranës. Ajo beson se Shqipëria do të ndryshojë gjithmonë dhe pozitivisht. Ajo beson tek fuqia e femrës dhe sa herë i jepet rasti e shpreh këtë. Pika e saj e dobët janë fëmijët, jo vetëm i biri, por çdo fëmijë në çdo cep të globit.

*Pse u përfshitë në politikë? Cilat janë sfidat tuaja, cilët janë mbështetësit, cilët janë kundërshtarët?*

Daton shumë kohë përpara dita kur u përfshiva në politikë. Kjo duket si një fjalë e madhe, ndërkohë që në karrierën e çdo politikani ka një ditë kur i bëhet ftesë nga dikush që është përfshirë më herët. Ky ka qënë rasti im dhe nuk ishte aspak në planet e mia të asaj kohe, sepse kisha një profesion i cili më sillte të ardhura të mira dhe më lejonte të bëja atë për të cilën isha lodhur dhe kisha punuar shumë vite dhe që është profesioni që kam.

E kam bërë këtë gjë në fillim me dëshirën për të ndryshuar qytetin ku unë isha lindur dhe rritur, që është kryeqyteti ynë. Kisha pak kohë që isha kthyer nga jashtë dhe e gjeta qytetin tim të transformuar negativisht dhe me shumë handikape, pa shërbime, të pistë, të palyer, të dhunuar dhe kjo ishte një shtysë shumë e mirë për mua që të gjitha dashuritë e mia i kisha brenda këtij qyteti. Une besova tek ai që më ftoi dhe që ishte në atë kohë kryetari i bashkisë së Tiranës dhe sot kryeministër i vendit dhe besova njëkohësisht edhe tek dëshira ime për të qënë pjesë e ndryshimit të qytetit. E kam thënë me përpara dhe e do ta them gjithmonë, qe këtë gjë e kam marrë si një sfidë dhe e kam bërë me forcën e vullnetit që ka dhënë rezultatet e veta. Në vitin 2004, Edi Rama u zgjodh kryebashkiaku më i mirë në botë, Tirana u transformua. Në ato vite unë thjesht dhe vetëm isha krahu i djathtë i një njeriu të spikatur në pushtetin lokal. Ky ka qënë rrugëtimi im 15 vjeçar, të cilin e theksoj, nuk kisha menduar kurrë që do të ishte kaq i gjatë.

***A është e lehtë të punosh pranë Edi Ramës?***

Mendoj që nuk jam unë personi i duhur për t'iu përgjigjur kësaj pyetje, për një fakt shumë të thjeshtë. Edi Ramën nuk e kam njohur ditën kur hyra në politikë, por shumë më herët. Pra kjo me ka ndihmuar që të kem një marrëdhënie tjetër, që ndoshta ndryshon nga ajo që kanë shumë njerëz që e kanë njohur për shkak të detyrës, ose që e kanë njohur vonë. Për mua është një marrëdhënie e ngushtë dhe fakti që unë jam këtu dhe mbas 15 vitesh si një nga bashkëpunëtorët e tij tregon që ka funksionuar, dhe pa kosto të jashtëzakonshme, përkundrazi.

Në këtë rrugëtim ti sigurisht që prek interesa, sepse merr vendime që mund të jenë të dhimbshme për dikë, ashtu siç merr edhe vendime që mund të kenë pasur ndikime pozitive për shumë njerëz. Kjo qoftë në përgjithësi qoftë në veçanti, por në fund të ditës mendoj që bilanci është gjithmonë pozitiv. Sepse e rëndësishme për mua ka qënë objektivi, pikësnyimi pozitiv dhe sigurisht shkuarja tek ky pikësnyim pa shumë dhimbje dhe besoj që kjo e ka bërë krejt pozitive gjithë këtë qëllim përsa i përket kësaj periudhe që mund të quhet të qenit në politikë.

***Kur hytë në fillim në politikë ishit e pamësuar me goditjet që mund të japin kundërshtarët. Si e përjetonit atëherë dhe si e përjetoni sot?***

Kam ardhur në politikë nga një fushë profesionale që ka qënë e lidhur me sistemin bankar. Kur hyra në politikë nuk ishte dita ime dytë e punës -kisha rreth 15 vite përvojë pune. Madje pune të bërë edhe përpara viteve 90, pra duke njohur edhe atë sistem, duke njohur edhe këtë. Kisha përvojat e mia brenda dhe jashtë vendit, kështu që nuk mund të them që hyra në politikë dhe gjeta goditje të mëdha të papërballueshme apo që u surprizova nga ndonjë gjë e panjohur më parë. Jeta politike është shumë më e ashpër sesa jeta jashtë saj për shumë arsye, por përvoja të ndihmon, por të ndihmon edhe karakteri, por të ndihmon edhe vënia e një pikësnyimi e cila të jep mundësinë të besosh tek vlera që i vë vetes, tek targeti që vë dhe për çdo ditë dhe më tepër të eliminosh të gjitha keqdashjet, presionet negative, paragjykimet dhe të vazhdosh rrugën tënde.



***Cili është mendimi juaj për zhvillimet politike në Shqipëri? Si kanë shkuar ato?***

Nuk mund ti përmbledh në dy fjali zhvillimet politike në Shqipëri, por sigurisht dua të ndaj miqësisht me ju, momentin që jetoj sot, duke qenë edhe për shkak të pozicionit që mbaj, për shkak të protagonizmit në këtë jetë politike. E kam parë këtë gjë me pozitivitet - besoj që Shqipëria për çdo ditë ecën nga pak. Diku edhe ndalet, por kjo ndonjëherë edhe bën mirë se të bën të reflektosh, diku edhe vrapon dhe kjo prapë të bën mirë sepse duhet të kapësh ritmin e të tjerëve, diku bën edhe hapa mbrapa dhe kjo gjë bën gjithmonë dëm, por gjithësesi besoj shumë që nga hapat mbrapa ne mësojmë për të mos i bërë më ato gabime, që të mos kthehen në faje.

Dialektika e zhvillimit të jetës politike në Shqipëri është tashmë e pandalshme. Shqipëria ka hyrë në rrugën e saj të drejtë të anëtarësimit, në rrugën e saj të drejtë të zhvillimit të një demokracie e cila me hapat e saj të vogla bën përmirësimet e saj çdo ditë, ka hyrë në rrugën e saj të zhvillimit të një shteti të së drejtës, e cila është fjalë e madhe, por që në fund të ditës Shqipëria do ta bëjë edhe këtë rrugëtim. Ka hyrë në rrugën e saj të drejtë të të qenit një shoqëri më e varfër se shoqëritë e tjera evropiane, por e drejtë dhe e ndershme për të pamundurit dhe shtresat vulnerabël, e cila kërkon një rritje të ndërgjegjes shoqërore në përgjithësi, e vështirë për tu realizuar. Ndoshta është më lehtë të ndërtohet një pallat sesa të ngresh një brez i cili të kete respekt për veten dhe për tjetrin, të ketë respekt për ambientin ku jeton, për institucionet. Asnjë shoqëri nuk e ka bërë këtë brenda ditës, Shqipëria nuk do të jetë ky rast, por sot unë besoj tek gjëja që bëj bashkë me kolegët e mi. Pranvera nuk vjen me një lule. Ne sigurisht nuk mund ta udhëheqim vendin drejt këtij rrugëtimi pa besimin e qytetarëve shqiptarë, besim që sigurisht krijohet.

Ne duhet të vazhdojmë ta krijojmë këtë besim dhe jo të mbetemi në fund të ditës tek batutat që "ah Shqipëria nuk bëhet, ah politika në Shqipëri, ah ne duhet të ikim nga këtu një ditë dhe më parë". Përkundrazi! E them këtë sepse e besoj. Unë përjetoj mungesat që vendi ynë ka si çdo qytetar i thjeshtë, madje ndoshta për shkak të detyrës perceptoj dhe pak më tepër sepse kam dhe një informacion më shumë, kam dhe ngarkesë më të madhe dhe përgjegjësi më të madhe, por kjo nuk më bën ta shikoj

gjysmën e gotës bosh, më bën ta shikoj gjysmën e gotës plot dhe do të vazhdoj ta shikoj njësoj edhe kur mos të jem duke bërë këtë punë që bëj sot, sepse nuk do vazhdoj të jem përgjithmonë në vallen politike që hiqet, se shpresoj shumë që të kem akoma shansin të bëj edhe gjëra të tjera në jetë.

*Cilat janë përparësitë e Shqipërisë dhe cilat janë sfidat?*

Sfidat janë të mëdha. Për një vend të vogël, bëhen akoma më të mëdha, unë në gjykimin tim mendoj që Shqipëria duhet të bëj hapa të vegjël, por të sigurt, jo të mëdhenj dhe të dyshimtë. Mendoj se sfida më e madhe e Shqipërisë sot është lufta për një sistem drejtësie transparent dhe të ndershëm. Besoj se reforma më e vështirë dhe sfida jonë më e vështirë është reforma në sistemin e drejtësisë, shteti i së drejtës në përgjithësi. Është një sistem i mahisur me abuzim, korrupsion, mungesë profesionalizmi, shtrembërime, por sigurisht nuk përjashtoj që edhe në radhët e tij ka profesionistë dhe njerëz të ndershëm. Besoj që një sfidë tjetër është edhe të mos largohemi nga tradita e mirë shqiptare. Vë re që sot ka më shumë fjalë dhe më pak vepra, lidhur me traditën. Tradita jonë është shumë e dashur, shumë fisnike dhe unë medoj që ne duhet të mbesim pak primitivë në thonjëza kur flitet për të, sepse kjo jo vetëm na bën ta respektojmë më shumë veten, por na bën që në këtë shoqërinë tonë të mund të vëmë akoma në qëndër të vëmëndjes njeriun, famljen, të cilën nuk e konsiderojmë më të shenjë, apo e konsiderojmë vetëm në fjalë, në sollgane, kur flasim për dogma, por nuk e zbatojmë.

*Si mundemi ta ruajmë traditën, pasi humbja e traditës ka shumë lidhje me varfërinë? Nga udhëtimet e mia nëpër Shqipëri, kam gjetur shqiptarë pa Shqipëri. Shteti nuk ishte i dukshëm..*

Kjo që ju thoni prek shumë tema, por kur unë flas për traditë e shoh kështu. Njerëzit dikur kanë qënë më të varfër, por më tradicionalë. Sot degjenerimi konsiderohet modernizëm, konsiderohet emancipim, gjë që nuk është fare e vërtetë. Sigurisht që shteti duhet të jetë prezent kudo. Po të mos harrojmë një gjë. Ne kemi zgjedhur një sistem ku gjithsecili duhet t'ia dalë vetë.

Shteti është vetëm rregullator i tregut. Padyshim që si një ekonomiste e majtë, besoj tek iniciativat që shteti duhet të marrë për të lehtësuar një industri, për të lehtësuar një ekonomi. Besoj tek taksimi i drejtë, por paralelisht me këtë besoj edhe tek fakti që më i zoti ecën më përpara sesa ai që është më pak i zoti.

Besoj edhe tek fakti që ne nuk duhet të presim gjithçka nga shteti. Nëse ne kemi tokën, duhet ta punojmë. Jo më larg se para disa ditësh shkova me një mikeshë të timen të mirë për të kaluar gjysëm dite në Velipojë. Nëse hyni tek kthesa e Bërdicës derisa të dilni në breg të detit do të shihni fusha të tëra të papunuara, djerrë. Shteti është i pari që u jep punë qytetarëve të vet, sepse puna ajo që të jep dinjitetin dhe është e drejtë kushtetuese dhe është e drejta e gjithkujt për ta pasur, vetëm se ne nuk duhet të rrimë dhe të presim që dikush të na japë punë. Ne si qeveri duhet që për çdo ditë dhe më tepër të kemi në qendër të vëmendjes punën për njerëzit, në mënyrë që në këtë politikën tonë të biem dakord për një gjë, që në qendër të të gjitha politikave, qofshin të majta apo të djathta, qofshin progresiste apo më pak, njeriu të jetë në qendër të vëmendjes. Kam udhëtuar për arsye pune në çdo cep të vendit, dhe ju keni të drejtë për diçka -ka vende ku njerëzit janë harruar, ka vende ku pak ndihet prezenca e shtetit, ashtu si ka vende ku shteti duhet të lerë konkurrencë të lirë, ku zgjedhja duhet të jetë e gjithkujt prej nesh.

***Çfarë mendoni për barazinë gjinore dhe si e shihni kuotën e 50 përqindëshit të grave në politikë? A i lë shteg ky favorizim konkurrencës së padrejtë?***

Unë kam qënë pjesë e diskutimeve dhe e debateve shumë herë lidhur me kuotat e barazisë gjinore. Është e vërtetë që ka një diskriminim pozitiv lidhur me këtë gjë. Shpeshherë i jam referuar një shembulli që vjen nga Pakistani i largët, por që në themel të atij vendi ka një bazë shumë interesante dhe të spikatur që është sistemi zgjedhor që i përafrohet deri në njëfarë mënyre sistemit anglosakson. Në sistemin zgjedhor pakistanez kuotat e barazisë gjinore janë 30 përqind dhe nëse forcat politike nuk janë në gjendje ti mbushin këto kuota me personat e duhur, karrigja rri bosh derisa të vijë personi i duhur për të zënë këtë vend.

Pra focat politike janë shumë të interesuara të gjejnë gra të zonja për të plotësuar këto vende. Ju thashë që ka qënë një diskutim i gjatë, unë nuk them që unë që kam qënë pro kutotave kam pasur 100 përqind të drejtë dhe ato që kanë qënë kundër nuk kanë pasur të drejtë, por di t'ju them që në eksperiencën time modeste kam qënë pjesë e sistemit mazhoritar, si edhe kam qënë pjesë e sistemit proporcional. Ka zona në Shqipëri që megjithëse ti je grua duhet të tregosh vetëm anën tënde mashkullore, e ke apo nuk e ke, dhe të trashësh zërin, përndryshe je e destinuar të humbasësh.

Në këtë regjim, ne duhet ti ndihmonim gratë me një sistem tjetër që është pikërisht ky sistem që kemi zgjedhur. Politika vë në fokus gratë në përgjithësi dhe nëse ne bëjmë një veprim të dyshimtë sulmohemi pikërisht për faktin që jemi femra dhe veprimi i bërë prej femrës konsiderohet i gabuar, ndërkohë që nuk konsiderohet i gabuar kur të njëjtin gabim e ka bërë një burrë dhe nuk themi se ai e ka bërë këtë gabim për faktin se ai është burrë, por gjejmë arsye të tjera.

Për mua më e rëndësishme sot sesa kuota është besimi që gratë duhet të kenë tek gratë sepse nëse ulesh të shikosh të gjitha statistikat është e vështirë të gjesh që gratë candidate janë votuar më shumë nga gratë sesa nga burrat. Është totalisht e kundërta. Pra vetë gratë nuk kanë besim tek gratë, megjithë që ti je aty për të folur për ato probleme që shqetësojnë gratë, sepse në fund të ditës unë jam një grua që kam të njëjtat vështirësi që ka çdo grua. Kështu që duhet rritur ky besim. Sigurisht ne që merremi me politikë duhet të jemi të parat që duhet ta bëjmë këtë gjë. Në gjykimin tim në disa fusha emancipimi i grave ka bërë hapa pas, përgjithësisht niveli i shkollimit të grave dhe vajzave sidomos shkollimi i mesëm është i ulët, pavarësisht se në universitete shihen më shumë vajza sesa djem.

E dyta, papunësia tek gratë është shumë më e lartë sesa tek burrat. Gjithashtu dhuna ndaj grave dhe kur flas për dhunën nuk flas vetëm për atë në familje, dhuna verbale vret më shumë sesa ajo fizike. Ne nuk jemi akoma në gjendje që megjithë se përballemi me një dhunë verbale të padëgjuar në parlament nuk bëhemi dot bashkë për tu thënë kolegëve tanë burra "Stop". Pra duhet ta tregojmë vetë fillimisht këtë unitet dhe ketë besim tek njëra-tjetra dhe pastaj t'ua imponojmë atë burrave. Të

gjitha këto aspekte e bëjnë gruan më vulnerabël, ndërkohë që shteti duhet ta ndihmojë gruan dhe t'i thjeshtojë jetën në disa drejtime, si kopshte dhe çerdhe më të mira. Gjithashtu shkolla me orë më të zgjata në mënyrë që gratë, përveç se përkujdesjes ndaj familjes të kenë kohë të bëjnë aktivitete dhe të rrisin profesionalisht veten e tyre dhe në këtë mënyrë të emancipohen çdo ditë dhe më tepër. E përsëris, emancipimi nuk ka të bëjë me degjenerimin, përkundrazi ka të bëjë me shkollimin, ka të bëjë me rritjen e aftësive për të qënë një kontribuese sa më e denjë në familje, në shoqëri. Ne kemi një traditë të mirë dhe gruaja shqiptare përshkruhet si një genie heroike, për shkak të së shkuarës historike dhe për shumë arsye të tjera. Duhet që të marrim më të mirën nga kjo gjë, por ne vetë duhet ta fillojmë këtë gjë që nga mënyra e edukimit të fëmijëve tanë dhe që nga mbajtja e një familjeje të shëndoshë që është qeliza bazë e shoqërisë. Nëse ne e prishim këtë qelizë ne nuk kemi ndërtuar asnjë gjë, le të ndërtojmë demokraci sa të duam, se kjo demokraci nuk do të jetë reale, por thjesht një fasadë.

### *Cila është çështja sociale më afër zemrës tuaj?*

Një çështje që mbetet gjithmonë pranë meje, përmbledhet vetëm në një fjalë, fëmijët. Unë jam munduar, pavarësisht sesa ja kam arritur, që të kem gjithmonë një sistem referimi, ai është im bir e si rrjedhim gjithë fëmijët kudo qofshin ata. Sot që flasim ne kemi bërë një ndërrmarrje modeste, kemi rikonstruktuar një ndërtesë të lënë pas dore brenda forcave të armatosura dhe e kemi transformuar në një kopësht për fëmijët autikë të prindërve anëtarë të forcave tona. Shpresoj që këtë projekt ta çojmë deri në fund dhe shpresoj që ky të bëhet një shembull modest edhe për të tjerët. Qendra do jetë gratis, është kontribut krejt modest po do të kemi një donacion dhe nga disa banka që po na e pajisin. Kemi punësuar njerëz të specializuar për këta fëmijë. Do trajnojmë dhe dy tre psikologë të tjerë brenda forcave të armatosura që të jenë edukatorë për këta fëmijë. Besoj që do të mbetet gjithmonë para syve të mi çdo fëmijë i kësaj bote kudo që të jetë, aq më tepër fëmijë që kanë nevojë edhe për shoqërinë.

***Cili është roli i medias në edukimin e shoqërisë? Besoni që pasqyrimi i lajmeve politike kaq gjerësisht i bën mirë shoqërisë apo mendoni që ne media ka nevojë të pasqyrohen pak më shumë problemet sociale dhe vetë shoqëria shqiptare?***

Besoj që lajmet sot janë të mbushura me kronikë të zezë, besoj që në emër të transparencës, abuzohet shumë. Besoj që në emër të pushtetit të pavarur në thonjëza, abuzohet po aq shumë. Kjo nuk do të thotë që nuk ka profesionistë të mirë, kjo nuk do të thotë që nuk ka njerëz të medias që realisht besojnë tek profesioni i tyre fisnik, por shpeshherë, sidomos kur mundem, zakonisht në mëngjes para sesa të vij për në punë, televizionin shqiptar dhe më ka qëlluar disa herë që TVSH të japë këngë tallava në një kohë kur duhet të japi një emision edukues, cilido qoftë ai.

Për fatin tonë të mirë, ne sytë sot na janë hapur dhe ty të mjafton vetëm një lëvizje me pultin e televizorit për ta çuar në një televizion tjetër siç mund të jenë stacionet shtetërore të Italisë ku ti shikon në mëngjes nga mënyra sesi gatuhet deri tek kurimi i një sëmundje. Emisione që të shërbejnë ty në fund të ditës për të qënë një qytetar i mirë. Kuptoj që tek ne mungojnë shumë lëndë formuese, lojra ambientet sportive, mungojnë vizitat në muze, në koncert, flas për fëmijët vegjël dhe kjo bën që nesër ne të rrisim një brez pa heronj, pa edukatë qytetare, pa sisteme referime që në fund të ditës e bëjnë shoqërinë shqiptare një shoqëri të dores së dytë krahasur me atë ku duam të shkojmë të integrohemi.

Unë jam kundra dhe do të jem kundra një fëmije që në moshën 10 vjeçare shet paketa në rrugë, jam kundër çdo prindi që detyron fëmijët, jam kundër dhunës në shkollë dhe në familje. Të dhunshmit sot janë 20 vjeçarë që nuk vijnë nga sistemi i kaluar, janë fëmijë të demokracisë që janë bërë të tillë gjatë rrugës ku ne kemi ndërtuar sistemin tjetër. Ne duhet të jemi të hapur dhe mediat duhet të jenë më pozitive dhe më dashamirëse edhe me personat publik që e bëjnë këtë punë. E kuptoj që media rri përballë nesh, por ne duhet të kemi disa pika të përbashkëta dhe ta ndihmojmë njëri-tjetrin. Ju nuk jeni perfekt, ne nuk jemi perfekt, ne jemi nën vëzhgimin tuaj po kjo duhet të ketë qëllimin e mirë jo atë të gjobëvënies, po atë të të qënit një pushtet që duhet respektuar e duhet të respektoj dhe veten duke bërë disa detyra që edhe ne si politikë

mundohe mi të bëjmë. Asgjë nuk është perfekte, por mediat duhet të riformatohen dhe të mos ketë vetëm politike në televizion për shkak të të kthyerit në qëllim në vetvete sepse politika duhet të jetë në funksion të mbarëvajtjes së disa gjërave për të cilat ne po flasim në këtë intervistë.

***Cilët janë gratë dhe burrat që ju kanë frymëzuar gjatë jetës tuaj?***

Ka vetëm një burrë dhe një grua, - dy prindërit e mi, për të cilët mendoj, edhe sot pas një karriere të spikatur, se nuk i kam arritur. Ata do të vazhdojnë të mbeten idhujt e mi. Njërin e kam yll në qiell e tjetrën e kam yll në tokë, do të vazhdoj ti shoh si yje që vështirë se do ti arrij ndonjëherë. Mendimi im për ta fillimisht ka ndryshuar kur jam bërë nënë për herë të parë sepse kam kuptuar se cila ishte qasja e tyre në raport me mua. Sot që mund të isha edhe gjyshe, besoj që ata kanë bërë heroizma të pamundura për të rritur dy vajza të mira dhe të edukuara për shoqërinë. Unë shpresoj shumë që të paktën nuk i kam zhgënjyer asnjëherë. Do të vazhdojnë të mbeten të paprekshëm në gjykimin tim, qoftë edhe duke gjykuar për veten që jam një mama e mirë, një nënë e mirë dhe dhë grua që jam përkujdesur shumë për familjen, jam një grua po aq e mirë, fati më ka ndihmuar të kem rritur një djalë të mirë për shoqërinë, por ende nuk i kam mbërritur kurrë ata të dy. Më ka ndryshuar gjithmonë dhe më shumë pozitivisht opinionin për ta. Sigurisht që vjen një moshë që të jep një farë ndjesie sikur unë jam prindi i mamasë time. Nuk kam mundur ta bëj këtë për tim atë që është larguar nga jeta shumë i ri, por shpresoj shumë që atje ku është të vazhdoj të mbetet krenar për vajzat e tij.

## **VOLTANA ADEMI**

nga Irena Shabani

Voltana Ademi flet ngadalë dhe qartë. Kjo është një armë e mirë në dorën e kryetares së re të bashkisë së Shkodrës: ajo i përcjell mesazhet aq kthjellët sa bashkëpunëtorëve u mbetet thjesht t'i vënë në zbatim. Ja sesi ajo i sheh sfidat që e presin në katër vitet e ardhme të qeverisjes.

*Pse u përfshitë në politikë? Cilat janë sfidat tuaja personale? Cilët janë mbështetësit tuaj dhe cilët janë kundërshtarët tuaj?*

Jam angazhuar herët në politikë - që në lëvizjet e para demokratike, në ngjarjen e 2 prillit. Isha nxënëse në shkollën "Jordan Misja". U bëra pjesë e asaj proteste - ishim ne nxënësit që e nisëm atë lëvizje, që fatkeqësisht përfundoi keq.

Vazhdova të isha e angazhuar politikisht edhe gjatë viteve studentore.

U ktheva në Shkodër për të marrë me politikë dhe për të dhënë më të mirën time, njëkohësisht për të qëndruar pranë prindërve dhe për të rindërtuar atë pak pasuri që na kishte mbetur nga komunizmi. Familja jonë ishte ndër më të pasurat e qytetit, prodhuese e duhanit Tarabosh, por sistemi komunist na i mori të gjitha.

Kam punuar herët për të ndihmuar familjen dhe për të shkolluar vetë. Jam marrë me shkrime në gazetari, apo me punë të ndryshme në sektorin e shërbimeve, si edhe kam punuar në aktivizimin e jetës sociale, këtë e kam bërë duke qenë vullnetare. Kam qenë ndër aktivistet e para për barazi gjinore bashkë me zonjat Valentina Leskaj, Diana Kastrati dhe Diana Çuli. Grupi i aktivisteve të Shkodrës krijoi qendrën e parë në mbështetje të gruas.

Kam qenë gjithashtu bashkë-themeluese dhe njëkohësisht kam dhënë mësim në universitetin Luigj Gurakuqi. Kam punuar pranë Partisë



Demokratike, duke ecur në gjurmët e nënës time, sepse ajo së bashku me gra të tjera kanë qënë ndër gratë e para të forumit të gruas të Partisë Demokratike.

Të qenit e djathtë lidhet me trashëgiminë familjare. Gjyshi im ishte anëtar i këshillit bashkiak dhe anëtar i forumit të dhomës së tregtisë së Shkodrës. Kjo është një histori e familjes të jep mundësinë që të bëhesh pjesë e saj, duke qënë se kthehet në gjenezë.

Pas vitit 2000 jam angazhuar në të gjitha fushatat e Partisë Demokratike të Shkodrës. Kam bërë çdo lloj pune aty, që nga komisionere, numëruese votash, ajo që troket derë më derë që të përfshijë të rinj në fushatë, hapëse e mitingjeve elektorale. Çdo gjë.

Ka pasur raste kur kam pasur kritikën e mia në trajtimin e disa çështjeve. Përveç Partisë Demokratike i kam shërbyer një linje që mendoj se është linja e duhur politikisht. Ky ka qënë një qëndrim imi konstant. Më pas kam kandiduar si anëtare e bashkisë së Shkodrës dhe më vonë jam zgjedhur nënkryetare e bashkisë.

Kuptohet kjo ishte eksperiencia ime e parë në administrimin publik vendor që ishte diçka krejtësisht e ndryshme nga ajo që isha mësuar të bëja në jetën akademike apo në organizata, në kontributin që kisha dhënë më parë, në fakultet apo në parti. Kjo në njëfarë mënyre është përgjegjësi tjetër, përgjegjësi e vërtetë. Sepse ne e themi shpesh shprehjen *qytetarë të përgjegjshëm*, apo që duhet të bëhen të përgjegjshëm, por kur vjen puna që të jesh pjesë e administratës, kjo nuk është më përgjegjësi teorike, është një përgjegjësi e vërtetë.

Duke ardhur nga jeta akademike, këtë përgjegjësi e kam marrë seriozisht së bashku me vështirësitë që shpesh më dukeshin të paimagjinueshme pse duhet të ishte kështu. Sepse kur je profesioniste duhet ti bësh gjërat në kohën e tyre, të respektosh procedurat, të veprësh në mënyrë transparente, kurse kur je në pushtet nuk është gjithmonë kështu, të takon të luftosh, më saktë të përballësh me shumë faktorë që nuk janë gjithmonë racionalë, janë edhe politikë, edhe të kontekstit, të qytetit apo të momentit.

*Ju keni punuar nënkryetare bashkie në një kohë të vështirë. Çfarë do të thoshte kjo për ju?*

Funksioni i nënkryetares së bashkisë ishte përvoja ime e parë në moshën 28 vjeçare. Kam punuar për 3 vite e gjysmë në Bashkinë e Shkodrës në një territor krejtësisht të varfër, në një territor pa vëmendjen qeveritare. Bashkia e Shkodrës së asaj kohe ishte krejtësisht e braktisur dhe në një gjendje mjerane, një Kandahar i vërtetë.

Nuk kishte investime. Mbaj mend veten në atë kohë teksa qëndroja prapa derës së zotit Blushi për të pritur dy milionë lekë të vjetra për të blerë naftë dhe për të ndezur gjeneratorin që të punonte administrata.

Këto janë ngjarje të jetuara se për investime as që bëhej fjalë. Situata ishte shumë e vështirë, sepse përballja ishte shumë e madhe. Mendoj që jam rritur në atë periudhë, i kam parë gjërat në një këndvështrim tjetër, më të thelluar, sidomos në marrëdhënien e komunikit dhe të marr vendime bashkarisht për aq sa kisha tagër.

Më pas jam angazhuar në Bashkinë e Shkodrës si anëtare e këshillit bashkiak dhe kryetare e grupit të këshilltarëve të djathtë në mandatin e zotit Luka.

Mund të them që veten nuk e kam trajtuar si partiake, sepse në këshillin e bashkisë jam ndjerë si përfaqësuese e qytetit. Duke diskutuar për problemet e qytetarëve ka pasur dhe raste kur nuk kam pasur të njëjtën qasje vendore apo politike, megjithatë edhe kjo është pjesë e një kontributi të rëndësishëm. Gjatë asaj periudhe kam punuar si administratore në një biznes privat që ishte kapital të huaj që investonte në Shqipëri. Kam punuar gjithashtu në shumë projekte zhvillimi duke qënë informatciene bashkë me ekspertë të tjerë në nivel vendor. Ne kemi nxitur dhe zbatuar projekte për shërbimin ndaj publikut, apo projekte për trajnimin e mësuesve për t'u thelluar në njohuritë informatike. Kjo është një eksperiencë shumë e vlefshme, ekspertiza ime ka qënë kryesisht në planifikimin strategjik dhe financiar.

***Pse pushteti vendor është një ndër pasionet e tua, çfarë është bërë shkas?***

Aktivizimi politik nuk është vetëm politikë, ai do të thotë gjithashtu mision për të përfaqësuar interesat e grupeve të komunitetit, të njerëzve që shkojnë dhe përputhen me filozofinë ku ti beson, në këtë rast të djathtë.

***Ka raste kur ndihesh e pazonja për të realizuar këto misione? Cila është ndjesia juaj?***

Brenda partisë unë mendoj që duhet të perpiqesh të ndryshosh. Në parti nuk funksionon teoria “unë mendoj që”, por “ne mendojmë që” dhe jo gjithmonë kjo “ne” është “ne” për të gjithë “ne-të”. Kjo është e rëndësishme të kuptohet sepse për këto raste ka diskutime të pafundme dhe jo gjithmonë mbetesh e kënaqur sepse ti beson në atë që ti beson, por kjo nuk është shpeshherë mendimi i të gjithëve. Megjithatë duhet të them se me gjitha përpjekjet ia kam dalë shpesh herë që këto ide të bëhen të të gjithëve. Në këtë kuptim dhe ky është në mision që e ka produktin e vet. Mendoj që ky është mision për të shërbyer. Unë isha shumë e kënaqur që edhe kur isha shumë e re arrija të realizoja me pak gjë diçka në shërbim të komunitetit. Unë punoj shumë orë, deri pasdite vonë, punoj në fakt nga mëngjesi në darkë.

***Nuk është sfilitës nje regjim i tillë?***

Unë jam e re dhe e përballoj me rini këtë ritëm. Unë kam një fëmijë 6 vjeç. Ai ka nevojë për nënën. Por unë gjej kohë edhe për të, e çoj dhe e marr vetë në kopësht. Im bir nuk arrin ta perceptoj se çfarë do të thotë ky lloj posti. Ai më pyeti se çfarë do të thotë krytare e bashkisë duke më thënë nëse kryetare do të thotë të shkosh përditë në punë apo ta duash djalin tënd më shumë. Dhe unë i thashë që duhet të duash djalin tënd më shumë dhe kjo është e vërtetë. Unë do mundohem të jem më shumë në shtëpi në aspektin fizik gjatë ditës. E kam bërë këtë edhe kur isha deputete dhe ishte shumë sfilitëse të bëje vajtje-ardhje Shkodër-Tiranë, por të paktën këtu kam patur mundësi të jem më gjatë me të. Unë e strukturoj mirë ditën time.

***Po në lidhje me kundërshtarët kur i ke ndjerë të tillë?***

Unë kam diçka, nuk i ndryshoj parimet dhe duke mos i ndryshuar parimet kjo të bën të jesh në vëmendje dhe këto parime nuk ndryshojne kur bëhet fjalë për punë të ndershme, bëhet fjalë për transarencë apo për luftë kundër korupsionit.

***Meqë dolëm tek korrupsioni sa shanse ka që pavarisht sesa e ndershme jeni ju, ta luftoni korrupsionin në një institucion kaq të madh sa bashkia?***

Unë nuk e mendoj, unë e besoj këtë. Sepse ne gjatë qeverisjes demokratike nuk kemi ndërtuar sisteme që do të thotë çfarë profili personi duhet për personat që duhet të kryejnë këtë detyrë në mënyrën më të mirë të mundshme. Një ndër gjerat më të para që ju shihni në programin tonë është pjesëmarrja qytetare dhe dixhitalizimin.

Pse? Sepse shpesh shohim njerëz që thonë se dalin në punë por në fakt shkojnë në kafe, nuk u kërkon kush një plan, nuk lënë gjurmë të punës së kryer dhe nuk raportojnë. Komunikohet në informalitet të plotë, nuk shkruhet gjë, prandaj unë do përdor mjetet teknologjike për çdo gjë.

Çdo punë duhet të dokumentohet. Kjo është një formë që lufton korrupsionin që në nivelin e parë dhe pastaj edhe sipër. Unë besoj në këtë. E vetmja gjë që shoh të vështirë është çfarë instrumentesh do gjejmë ne për ta bërë të mundur këtë. Sepse ne sa kemi njerëz ekspertë po aq nuk kemi. Është një proces i gjatë, dhe keto principe jo gjithmonë janë të të gjithë grupit. Kjo është sfilitëse sepse ti duhet të punosh shumë për të realizuar atë që do, ndërkohë që ka edhe mosbesues dhe të lëkundur. Përdorimi i politikës për politikë, kjo është diçka e rëndë që ndodh në Shqipëri, por nuk u shërben njerëzve. Kjo është një pjesë e madhe vështirëse.

Kam vënë re edhe diçka tjetër në fushatë, po flas për Shkodrën, se këtu e kryej aktivitetin tim. Për shkak të së kaluarës në një sistem komunist e kemi vështirë të mendojmë pozitivisht, që do të thotë më parë bëjmë

pyetje që kundërshtojnë sesa përpiqemi të ndërtojmë së bashku mbi një propozim. Ky është mentaliteti, jemi mosbesues.

***Si e shihni Shqipërinë?***

Shqipëria mbetet një vend i varfër sepse nuk po arrijmë të krijojmë sistemin. Nuk duam. Janë të lidhura bashkë për interesa të vogla. Unë besoj që ne mund ta bëjmë. Unë mund ta filloj nga Shkodra. Unë jam kthyer për të jetuar në Shkodër sepse dua të bëj diçka në vendin tim. Prandaj ne duhet të ndërtojmë gjëra pozitive, mos të shkelim me këmbë ato që janë ndërtuar. Ne nuk duhet të jemi konfliktuale, pavarësisht se ky mentalitet po ndryshon. Ne akoma jemi mosbesues për të tjerët, për botën. Europa funksionon ndryshe në marrëdhënie me njëri-tjetrin, në grup apo me gjere, ka pozitivitet. Këto janë principe që ne duhet të kthejmë në vepra.

***Gjatë fushatës ju keni bërë dalje publike me kundërshataren tuaj për postin e kryetares, zonjën Keti Bazhdari. E kujt ishte ideja?***

Unë e kam mirëpritur gjithmonë një diskutim publik, sepse unë doja ta ndaja me të tjerët atë që doja të bëja. Marrëveshja është respektuar nga ana ime, sepse unë besoj që ne jemi aty për qytetarët, jemi njerëzit që do shërbejmë. Diskutimet publike kanë qënë të inicuar nga shoqëria civile, organizata ndërkombëtare ose media, për të diskutuar për alternativat tona. Nuk mendoj që kjo përballje ka qënë e tillë sepse ne jemi femra, por mendoj që kjo ka të bëjë me vetë personin dhe mënyrën sesi e percepton ai një përballje të tillë dhe sidomos në nivel lokal. Unë jam kryetarja e të gjithëve dhe të njëjtin raport do kem me çdo qytetar pavarësisht bindjeve politike të secilit

***Si e shihni ju raportin e medias me politikën, çfarë mungon në ekranet tona?***

Më vjen keq që shpesh politika e përdor median për spektakël dhe shpesh nuk i jep mundësinë publikut për tu thelluar në diskutimin më të thellë të çështjeve. Kjo është e dukshme dhe imponuese. Po të ecni

në rrugët e qytetit njerëzit flasin vetëm për politikën, unë do preferoja që ata të flisnin për çështje që na prekin të gjithëve. Media është një instrument, por duke e trajtuar në aspektin social unë preferoj që njerëzit të diskurojnë, jo të kritikojnë vetëm se kjo është shumë kollaj. Kjo duhet të pasqyrohet në media, brumi intelektual të shfaq mendimin e tij.

***Cilët janë njerëzit që të kanë frymëzuar në jetë?***

Babai im. Ai nuk jeton më. Ka qënë prind shumë i mirë, njeri shumë punëtor. Ka qënë nja artist amator, mjeshët i modelimit të detaleve për makineritë bujqësore. Ai ka qënë gjithashtu sportist për 10 vite në basketboll. Ka qënë i shkëlqyer në çdo gjë që ka bërë, i ndershëm dhe punëtor, familjar dhe njeri i afërt. Ai thoshte gjithmonë se të punosh drejt ia vlen gjithmonë se njëherë mbërrin. Nuk duhet të mërzhitesh, duhet të punosh për atë që është më e mira për ty.

Ai thoshte *garo për notën 10, ky duhet të jetë qëllimi*. Ka qënë vetëmohues dhe mendoj që karakteristika të tij kam edhe unë. Personi tjetër është nëna, konservatore, jo e rreptë, por me rregulla. Ata të dy ishin dy partnerë shok me njëri-tjetrin. Kam pasur familje model. Më kanë mbështetur në formimin tim, pavarsisht se ne ishim të varfër. Më kanë asistuar gjatë studimeve të mia. Në sipërmarrjet e mia publike ata më kanë mbështetur pa kufizim.

***Ju keni në administrim një bashki të bukur - çfarë mendoni se do ndryshojë në këto katër vite?***

Administrimi publik, mënyra sesi do ofrohet shërbimi publik për qytetarët, jo vetëm në cilësi, por sidomos në aspektin e komunikimit dhe të shërbimit. Do të luftoj korrupsionin, do të ketë transparencë dhe pjesëmarrje qytetare, gjithashtu për standartin e shërbimit do të përcaktoj kostot, do respektoj ligjin, do bëj staf profesional. Premtimi që do respektojmë ligjin duket i habitshëm, por kjo është ajo që ne do duhet të bëjmë. Do përpiqem të marr sa më shumë donacione nga projekte shumë të mira të huaja. Shkodra e ka këtë traditë. Në lidhje me papunësinë, ky është prioritet dhe ne do investojmë direkt si në bujqësi,

turizëm dhe tregti, duhen paketa tuistike, promovime, gjithë zinxhiri. Punësimi rritet kur rritet produkti.

Ne do punojmë si ndërmjetësues për të tërhequr biznese të huaja të cilat do t'i orientojmë drejt.

***Mendoni që do të hasini vështirësi në bashkëpunimin me qeverinë si bashki e djathtë?***

Nuk mendoj që do kemi vështirësi për marrje fondesh. Mendoj pa modesti që ne do i paraqesim qeverisë shumë projekte. Une kam dëshirën e mirë për të qartësuar çdo gjë që është teknike. Unë besoj që komunikimi qartëson shumë gjëra.

## **ALBANA VOKSHI**

Kuotat nuk mjaftojnë, politika ende e kontrolluar nga burrat

nga Gjergj Erebara

Deputetja demokrate beson se pavarësisht përparimit në dekadat e fundit, gratë ende vuajnë nga pabarazia në pagë, nga puna e papaguar në familje dhe papunësia më e lartë. Kuotat e pjesëmarrjes në politikë mund të krijojnë raport të vështirë mes sasisë dhe cilësisë. Misioni i saj: të luftojë kundër shkeljes së të drejtave të grave.

*Si i vlerësoni ndryshimet në shoqërinë shqiptare përgjatë dy dekadave të fundit në raport me rolin e gruas në shoqëri? Në cilat drejtime janë vërejtur përmirësime dhe në cilat, përkeqësime?*

Jemi në 25 vjetorin e përmbysjes së regjimit diktatorial në Shqipëri. Është shumë e rëndësishme të qartësojmë etapat e historisë së të drejtave të grave, pasi në këto 25 vite, sfidat kanë qenë të jashtëzakonshme; me shumë barriera, revolucione në mentalitet, por dhe arritje befasuese. Në këtë aspekt, roli i gruas shqiptare ka qenë historik, duke filluar me angazhimin e guximshëm të tyre në Lëvizjen e Dhjetorit '90 për përmbysjen e komunizmit dhe themelimin e partisë së parë opozitare, Partisë Demokratike.

Duhet thënë se roli i grave dhe vajzave në proceset transformuese të Shqipërisë është befasues. Për të ardhur direkt në thelbin e pyetjes suaj, mendoj se arritjet kanë qenë më shumë cilësore, se sasiore. Gratë kanë rritur vetëdijen për të drejtat e tyre, duke i bërë barrikadë edhe stereotipeve gjinore. Por gratë dhe vajzat kanë investuar më shumë për profesione me tipologji gjinore, duke rritur pabarazinë në pagë me burrat, pasi shumë prej tyre janë angazhuar në arsim, shëndetësi dhe në biznese shërbimi. Shqipëria në këto dy dekada ka rritur ndjeshëm numrin e grave dhe vajzave në universitete. Shumë prej tyre kanë përfunduar studimet në shkollat më të njohura në Evropë dhe SHBA. Gratë kanë rritur përfaqësimin e tyre në politikë dhe vendimmarrje, edhe pse ende ka shumë punë në këtë drejtim.



Nga ana tjetër, për sa i përket përqësimeve, mendoj se gratë kanë një pozitë ende të brishtë në raportet familjare, në respektimin e të drejtave ekonomike, të drejtës për pronën dhe të drejtën për të punuar. Gratë ende bëjnë punë të papaguar në shtëpi. Ende ka raportime se gratë dhe vajzat nuk paguhen dhe nuk janë të siguruara edhe në sipërmarrjet ku punojnë. Ndërsa gratë në fshat pothuajse nuk gëzojnë asnjë të drejtë në këtë drejtim. Statistikat flasin për një status të rënduar socialekonomik të grave. Papunësia ndër vajza e gra është shumë e lartë dhe vazhdon të rritet çdo muaj, bazuar në statistikën e INSTAT. Vetëm gjatë tremujorit të fundit ajo është rritur me 0.8%.

Një fenomen shumë shqetësues është dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave dhe vajzave. Nga ana tjetër po kaq alarmant është dhe realiteti i vetëvrasjeve të nënave dhe grave, që jeta u është bërë e pamundur dhe e pashpresë. Humbja e shpresës ka bërë që mijëra gra e vajza të marrin rrugët e emigrimit dhe të kërkojnë azil në Gjermani apo në vendet e tjera të BE-së. Këto janë lajme që jo vetëm më trishtojnë, por më dekurajojnë edhe për të ardhmen e shoqërisë.

*Gjatë viteve të fundit, pjesëmarrja e grave në jetën politike shqiptare, si në pushtetin vendor ashtu edhe në parlament apo pushtetin qendror ka shënuar rritje. Çfarë të mirash mendoni se ka sjellë kjo rritje e pjesëmarrjes së për shoqërinë shqiptare?*

Mendoj se 25 vite përpjekjeje të jashtëzakonshme, të bëra nga vetë gratë, nuk kanë sjellë rezultatet e pritshme. Sepse më shumë gra në politikë e në administratë do të thotë më shumë politika të përgjegjshme dhe sociale. Më shumë gra në poste kyçe, më pak korrupsion. Më shumë gra në vendimmarrje, më pak kriminalizim të politikës dhe administratës.

Në zgjedhjet lokale të qershorit, pas një pune dhe lobimi të madh të bërë nga Aleanca e Grave Deputete si dhe nga pothuajse të gjitha gratë deputete, lidershipi politik lejoi përfaqësimin e barabartë gjinor në [listat e kandidatëve për] këshillat bashkiakë. Por në listat e kandidatëve për kryetarë bashkie, gratë nuk zunë vendin e duhur dhe paragjykimi gjinor u bë kryefjala e fjalimeve të Kryeministrit gjatë fushatës elektorale.

Ne arritëm me sukses rritjen e përqindjes së pjesëmarrjes së grave në këshillat bashkiakë, por dështuam në përpjekjet për rritjen e numrit të grave kandidatë për kryetarë njësisish vendore, si dhe rritjen e kuotës së grave në listat e partive politike për përfaqësimin në Parlament. Po ashtu, seancat plenare mbizotërohen nga fyerje banale dhe mungesë etike në drejtim të grave parlamentare. Fjalori pa etikë ka bërë që seancat të kthehen në dëgjesa të papranueshme për familjarë dhe fëmijë.

Pra, shumë është bërë, por statusi i gruas në politikë dhe vendimmarrje është ende i brishtë!

***A është shoqëruar kjo rritje sasiore e pjesëmarrjes së grave edhe me rritje të kontributit të tyre në politikë?***

Ka pasur rritje, por sikurse u shpreha mendoj se ende gratë dhe vajzat janë të nënpërfaqësuara në politikë dhe në vendimmarrje. Nga ana tjetër, detyrimi i kuotës ndonjëherë mund të krijojë një raport të vështirë mes sasisë dhe cilësisë në përfaqësimin e grave. Asnjë shoqëri nuk ka nevojë për “marioneta” në institucione. Në Qeveri dhe Parlament është rritur kuota gjinore e përfaqësimit dhe unë shpreh bindjen se shumica e tyre e meritojnë dhe janë shumë më të afta se shumica e burrave në ekzekutiv dhe legjislativ. Pra, në kërkim të rritjes së kuotës, nuk duhet asnjëherë të biem në kurthe statistikore, që gratë të prezantohen thjesht si numra, por duhet të kenë e të sjellin eksperiencë nga më të mirat për t’i vënë ato në shërbim të qytetarëve.

Është fakt që sistemi aktual zgjedhor e lë përzgjedhjen e kandidatëve (gra dhe burra) në dëshirë të liderëve politikë dhe në raste jo të rralla, kontributet, eksperiencë, talenti dhe aftësitë tejkalohen nga qokat politike. Ndaj, edhe forcimi i rolit të strukturave dhe forumeve të grave të partive politike është vendimtar, në mënyrë që të përgatisë, të propozojë dhe të imponojë kandidatë të afta e të zonja për të qenë pjesë integrale e fushatave qendrore apo lokale.

Pra, partitë politike nuk mund dhe nuk duhet t’i përdorin gratë për fasadën e fushatave elektorale dhe për këtë revolucion mentaliteti, zëri i

grave dhe vajzave duhet të dëgjohet më shumë. Gratë, të cilat përbëjnë gjysmën e popullsisë së vendit gëzojnë të njëjtën të drejtë natyrale të përfaqësimit në politikë dhe vendimmarrje ashtu si burrat.

*Cilat janë sfidat kryesore me të cilat përballen gratë e përfshira në jetën politike shqiptare?*

Gratë në politikë janë ende në sfidën e nënpërfaqësimit. Drejtimin e institucioneve e kanë në dorë burrat dhe superioriteti maskilist degradon me forma të ndryshme kërcënimi dhe dhune verbale dhe psikologjike. Nga ana tjetër vazhdon të qëndrojë temë dite lufta brenda të njëjtës gjini, dhe gjithmonë kjo dobësi përdoret për interesa të ngushta politike të burrave. Gjithsesi, jam e bindur se ka një rritje cilësore në debatin mes grave dhe burrave në politikë dhe se zëri i gruas në Parlament ka filluar të dëgjohet falë performancës profesionale të grave deputete!

*Çfarë hapash konkretë duhet të ndërmerren në mendimin tuaj për të fuqizuar rolin e gruas shqiptare në politikë dhe vendimmarrje? A mendoni se sistemi i kuotave është i mjaftueshëm për të arritur këtë?*

Roli i gruas në vendimmarrje dhe politikë shkon përtej vendosjes së kuotave. Asnjë numër nuk mund t'i vendosë gardh të drejtës së përfaqësimit të grave përsa kohë që vota e tyre ka të njëjtën vlerë me atë të burrave. Lobet dhe mbështetja për këtë kauzë duhet të kenë në vëmendje të tyre që gratë duhet jo vetëm të jenë më të shumta në numër në Parlament, por ato duhet të kandidojnë për postet më të rëndësishme të shtetit dhe nuk duhet të kufizohen me përfaqësimin në këshilla bashkiakë. Administrimi i pushteteve nga gratë është edhe një formë e luftimit të korrupsionit në të gjitha nivelet e qeverisjes. Po ashtu, mendoj se partitë politike duhet të afrojnë pranë tyre më shumë gra dhe vajza.

Nga ana tjetër, një rëndësi prioritare merr shkollimi dhe edukimi, që mbetet ende një e drejtë e mohuar për shumë gra e vajza përsa kohë që nuk kanë mundësi ekonomike dhe punësim. Ministria e Arsimit dhe ministria përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të grave duhet të kenë planveprime konkrete dhe jo thjesht propagandë ekranesh dhe tabloidësh...

***Çfarë mendoni se duhet bërë që pjesëmarrja e grave në politikë të sjellë edhe ecuri përpara drejt treguesve të tjerë të barazisë gjinore si mbyllja e hendekut ekzistues në nivelin e pagave për pozicione të njëjta?***

Legjislacioni gjinor në Shqipëri është i avancuar, por institucionet përgjegjëse kanë humbur kontrollin mbi territorin pas shkatërrimit të Mekanizmave Institucionale për Barazinë Gjinore, si në Ministrinë përkatëse ashtu edhe në pushtetin lokal. Nëpunësit gjinorë të emëruar në ministri dhe bashki u zëvendësuan me militantë politikë dhe gratë mbetën të nënpërfaqësuar dhe pa mbrojtje sociale e ligjore. Gjithashtu, reforma territoriale ka krijuar hapësira boshë në drejtim të rikrijimit dhe aktivizimit të këtyre mekanizmave, jo vetëm për gratë dhe fëmijët, por edhe për pensionistet. Është një investim i madh shumëvjeçar i Qeverisë Shqiptare në bashkëpunim me organizma ndërkombëtarë për krijimin e mekanizmave mbrojtës për gratë dhe fëmijët; mekanizëm i cili nuk duhet të zhbëhet!

Parlamenti ndërkohë po diskuton ndryshimet në Kodin e Punës, ku të drejtat e grave kanë tendencë për t'u shkelur. Komisioni që unë drejtoj [Komisioni Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë] pati diskutime të gjata dhe të detajuara rreth këtij dokumenti dhe rrëzoi nenin që favorizonte zgjatjen e orarit zyrtar të punës në sipërmarrjet private. Në bashkëpunim me Aleancën e Grave Deputete dhe nënkomisionet parlamentare, ne organizuam dëgjesa me palët e interesit për të vendosur për një mbrojtje më të madhe të të drejtave të grave në punë, përfshirë edhe kërkesën për pagë të barabartë me burrat.

Cjykoj se Parlamenti duhet të rrisë kontrollin mbi institucionet përgjegjëse për garantimin e të drejtave të grave për të shtuar llogaridhënien për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Reduktimin e Dhunës në Familje dhe për t'u ofruar grave dhe vajzave shërbimet e munguara. Tërheq edhe vëmendjen e shoqërisë civile dhe aktivistëve të të drejtave të grave për të denoncuar rastet abuzive, pasi në shumë raste organizatat e grave kërcënohen me refuzim të bashkëpunimit institucional nëse në projektet e tyre ka kritikë për punën e qeverisë. Në këto dy vite qeveria ka sjellë në Parlament ligje që kanë tentuar të dhunojnë të drejtat e njeriut dhe të drejtat e grave, ndërkohë që zëri i shoqërisë civile pothuajse nuk është dëgjuar!

Gratë sot janë më të varfra dhe ne duhet të kërkojmë llogari se ku kanë shkuar projektet për fuqizimin ekonomik të tyre dhe zvogëlimin e hendekut gjinor në paga.

*Bazuar në eksperiencën tuaj personale, cili mendoni se ka qenë kontributi juaj kryesor dhe konkret në këtë drejtim?*

Është e vështirë të flasësh për veten, ndaj mund të them vetëm që puna ime me strukturat e grave të PD ka qenë sfida më e madhe, por edhe më e bukura deri më tani në jetën time politike. Besoj që ia kam dalë që me një grup grash e vajzash të palodhura dhe të përkushtuara të ngre një strukturë reale dhe efeciente, Lidhjen Demokratike të Gruas së Shqipërisë. LDGSH shtrihet në çdo njësi administrative dhe sot numëron mbi 20 mijë anëtare në gjirin e saj. Është ngritur një strukturë e mirëfilltë, që është forcuar ndër vite dhe zëri i të cilës ka filluar të dëgjohet më shumë, pavarësisht refuzimit të disa drejtuesve "fanatikë" të PD-së në degë të ndryshme që e konsiderojnë politikën si "zanat" të burrave.

## **RAJMONDA BALILI**

nga Irena Shabani

Rajmonda Balili është një grua e qetë, me një buzëqeshje të mirë, të cilës i shkëlqejnë sytë kur flet për qytetin e saj dhe për emocionet pozitive që ka marrë gjatë mandatit të shkuar si kryebashkiake. Mandat të cilin e rifitoi në kandidimin e zgjedhje të 21 qershorit. Ajo është ekonomiste, profesion ky që e ka shoqëruar gjithë jetën dhe që e ka bërë po me kaq dëshirë sa bën kryetaren e bashkisë së Patosit, i cili duhet thënë që në 20 vitet e fundit nuk është më qyteti i naftëtarëve, por qyteti i ish-naftëtarëve. Ndoshta sepse politikat e shtetit në këto 20 vite diku kanë çaluar dhe qyteti i Patosit ka pasur rrjedhje intelektuale dhe prurje rurale. Megjithatë edhe pse mundësitë e tij nuk janë shumë të mëdha, Rajmona Balili dhe bashkia e saj ka bërë atë që ishte e domosdoshme, tu jepte qytetarëve që kanë vendosur mos të ikin nga ai qytet një jetë më të mirë, me më shumë mundësi punësimi, më shumë rrugë të asfaltuara dhe më shumë mundësi zhvillimi për të ardhmen. Rizgjedhja e saj në krye të bashkisë është padyshim meritë edhe e këtyre sukseseve!

***Pse u përfshitë në politikë? Cilat janë sfidat tuaja personale? Cilët janë mbështetësit tuaj dhe cilët janë kundërshtarët tuaj?***

Përfshirja ime në politikë nuk ka qënë qëllim në vetvete. Në vitin 2000 jam propozur për nën-kryetare të Bashkisë Patos. E kam pranuar këtë propozim si një përgjegjësi më shumë, ndërkohë mundohesha të isha pjesë aktive e shoqërisë civile të asaj kohë. Në vitin 2007 kam patur ftesë nga Partia Socialiste për të kandiduar për kryetare bashkie, por nuk u realizua për shkak se Bashkia Patos në këto zgjedhje iu la aleateve. Në vitin 2011 përsëri më erdhi ftesa për kandidim nga e njëjta forcë politike. Kam pranuar të kandidoj për drejtimin e bashkisë pasi profesioni im, por dhe njohja me pushtetin vendor me ndihmonin për të marrë një vendim të tillë. Por gjithmonë e kam ndarë politikën nga menaxhimi dhe bërja e politikave të zhvillimit vendor. Jo se më tremb politika apo është tabu, jo. Por ndoshta modeli i politikanit menaxher, administrator i aftë për të drejtuar dhe orientuar politika zhvillimi, politika shërbimi, politika sociale, ndoshta është modeli për të ndryshuar mendimin e të marrurit me politikë apo vlerësimin popullor kundrejt politikës. Në këndvështrimin

tim personal, sfidat e mia janë në këtë fushë: të jem një administratore e mirë, të orientoj drejt politikat e zhvillimit të bashkisë time, të rris kënaqshmërinë qytetare nëpërmjet rritjes së cilësisë së shërbimeve, të zbus problemet sociale nëpërmjet këtyre politikave, të promovoj emrin e mirë të qytetit tim, bashkisë, në arenën kombëtare pse jo dhe në atë ndërkombëtare nëpërmjet arritjeve në fusha të ndryshme dhe potencialeve që ka ky qytet.

Mbështetësit e mi të gjithëkohshëm janë familjarët e mi, janë motori që vënë në punë gjithë energjitë e mia dhe stafi, koleget, bashkëpunëtorët, ku pas çdo suksesi qëndrojmë të gjithë bashkë. Ndërkohë që nuk i mendoj kundërshtarë ata që ndoshta për arsye nga më të ndryshmet nuk i miratojnë këto politika. Pra nuk janë kundërshtar në aspektin profesional apo personal, mund të jenë kundërshtar, (nese do ti konsideronim të tillë), ideologjik.

### ***Si është të jesh kryetare e një bashkie jo shumë të pasur si Patosi?***

Patosi është një tranzit aty ku është, sepse qëllimi për të cilin ai u ngrit, sot, nuk është më. Ai u ngrit si qytet naftëarësh, por sot nuk është i tillë. Edhe kur ne mundohemi të hartojmë strategji të zhvillimit të Patosit jemi në dilemë se cilat do të jenë rrugët, ne thjeshtë duam që ta zhvillojmë si qytet, ti ofrojmë gjithë infrastrukturën e nevojshme me qëllim që vetë qytetarët të ndihen mirë aty ku jetojnë, por njëkohësisht edhe fusha e bujqësisë. Sepse me ndarjen e re territoriale aktualisht Patosi ka 60 përqind të popullsisë të lidhur drejtëpërsëdrejti me bujqësinë dhe blegtorinë, ne do të përqëndrohemi në këto fusha, sidomos ullishtet. Ndërsa në këndvështrimin turistik Patosi nuk ofron shumë. Këtu mund të përmendet kalaja e Margëllicit, e cila emrin e vjetër e ka Orgesus. Sistemi i naftës do vazhdojë të jetë. Fusha naftëmbajtëse shtrihet nga nga Patosi deri në Marinëz. Kompanitë janë konçesionare dhe Albetroli ka mbetur si objekt shërbimi, kështu që nuk e shoh me prespektivë. Tani kanë ikur shumë intelektual dhe brumi më i mirë, ndërsa prurjet janë të zonave rurale. Mungesat intelektuale ne i kemi sot dhe në administratë si në fushën e arkitekturës apo edhe financiarë. Nëse nuk projektojmë është e kotë të kërkojmë.

***Çfarë ke arritur në krye të kësaj bashkie?***

E kam thënë edhe herë të tjera që vendet e pasura në nëntokë janë të varfëra mbi tokë. Kjo ka të bëjë me politikat e shfrytëzimit të pasurive nëntokësore. Unë jam rikandiduar se diçka ka patur progres. Ne kemi mundur të bëjmë investime edhe me ato pakë lekë, kemi menaxhuar më mirë, kemi bërë shpërndarje më të mirë. 50 përqind e popullsisë jeton në fshat dhe tjetra në qytet. Ne patëm tendencë për të fituar nga renta minerare, por me akte normative na u mbyllën shtigjet për ta përfituar atë rentë. Renta ishte një fitim nga pasuria nëntokësore që shkonte direkt tek qytetarët. Tashmë duhet të bëhet një ligj që ajo rentë të shpërndahet në formë granti. Në Patos nuk ka biznese ndërtimi, ka biznese të karakterit familjar dhe karburantet. Ne numërojmë 54 biznese të mëdhenj dhe vetëm një fason për këpucët dhe tani kemi afuar një fasoneri turke rrobaqepsie ku kemi punësuar 150 gra ng 600 që ishte numri i atyre që aplikuan. Fasonet janë mundësia më e mirë për të siguruar diçka, por nuk janë fortë fitim-prurëse. Ne po mundohemi të marrim si asete të bashkisë ish ndërmarrjet e naftës të cilat mund ti japim me qira për fasoneritë dhe një prej tyre ta kthejmë në pallat sporti. Ne kemi shtruar mbi 5 kilometra rrugë, me ndiriçim dhe kanalizim, dhe tani banorët i janë rikthyer xhiros së mbrëmjes. Tani po heqim rrethimet brenda pallateve. Kemi ndërtuar lulishte, kënde lojrash për fëmijë dhe ambiente për të moshuar.

***Çfarë impresiononi ke marrë si kryetare bashkie, negative dhe pozitive?***

Është e vërtetë që është ndryshe të bësh jetën e një njeriu të thjeshtë dhe ndryshe të ndryshosh një bashki. Kam pasur gjithmonë ndjenjën e brëndëshme të drejtueses, por këndvështrimi që të marrësh një post ka të bëjë dhe më fatin që je e predispozuar për tu goditur nga thashethemet dhe nga përballja me këtë lloj realiteti. Kjo punë të privon nga shumë gjëra, qoftë edhe të bërit pazar ashtu si ti e do si grua, të kalosh kohë me miq dhe mikeshë, por ka kënaqësi të tjera, unë marr sadsifaksion nga çdo qytetar që më thotë; Faleminderit, për rrugën që na bëre apo për të tjera. Dita ime më e vështirë është dita e enjte, kur pritja me qytetarët më vë të dubloj veten, sepse halli i tyre real është papunësia. Ne me shërbimet e tjera jemi në kontakt të përditshëm, ndërsa ajo që është



çështja më e mrehtë është papunësia. Ne kemi disa alternativa për të mundur fenomenin e papunësisë, por është akoma larg të siguruarit punë për të gjithë.

### *Cili është mendimi juaj për zhvillimet politike në Shqipëri?*

Shqipëria është sot këtu ku është falë politikës 20 e kusur vjeçare të elitës që ka udhëhequr vendin tonë në këto dekada. Vitet e fundit kemi shpresuar shumë ndryshime në të gjitha kënd-vështrimet, por në fakt kemi vuajtur dhimbjet që janë shkaktuar për vite me radhë nga politika e destabilizimit, përçarjes e moskokëçarjes për fatet e vendit, që sot më shumë se kurrë presim të pranohemi si anëtarë me të drejta të plota në Bashkimin European. Ka patur një kahje pozitive për të lëvizur nga politika shterpe që nuk prodhonte atë që shqiptarët prisnin nga kjo klasë politike, tek kompromisi, mirekuptimi, kur bëhet fjalë për çështje kombëtare.

Dhe jam e sigurtë se me këtë klimë të politikës shqiptare, ku në vend të debateve stresuese për qytetarët në sallën e parlamentit shqiptar apo në hapësirat e mediave që nuk prodhojnë vendime apo zhvillime konstruktive, të ekzistoj fryma e konsensusit dhe bashkëpunimit midis palëve e që kërkohet me forcë dhe nga ndërkombëtarët, atehere politika e viteve të shkuara do të mbetet një e shkuar në historinë e viteve që po lëmë pas.

Por unë jam e bindur gjithashtu se sot në Shqipëri si rrallëherë, kemi një mazhorancë qeverisëse të gatshme për të bashkëpunuar me opozitën parlamentare. Kjo politikë sot, është premtuese për të ardhmen e vendit tonë nesër.

### *Çfarë do të ndryshojë në Shqipëri në katër vitet e ardhshme? Cilat janë përparësitë kryesore të Shqipërisë dhe sfidat?*

Kur flasim për ndryshimet që presim në Shqipëri në katër vitet e ardhshme, duhet të shikojmë me kujdes ecurinë e zhvillimeve dhe ndryshimeve në gjithë vitet e tranzicionit. Sfidat janë të shumta, por mundësitë për ato që

duhen bërë dhe dëshirojmë të bëhen, janë paksa në proporcion të zhdrejtë me pritshmëritë e mëdha që kemi. Përpyekja e Shqipërisë për reforma të vazhdueshme kërkon vullnet të hekurt, por vetëm kështu mund të arrihet progresi drejt BE-së. Vlejnë për tu përsëritur nismat konkrete që lidhen me procesin e reformave me BE-ne, ku qeveria ka vazhduar të zbatojë dhe ti konsolidojë me tej masat në reformën gjyqësore, në luftën kundër korrupsionit dhe ndaj krimit të organizuar. Gjithashtu reforma administrative është tregues i rëndësishëm në arritjen e standarteve.

*Çfarë mendoni për barazinë gjinore në Shqipëri? Si e shihni zbatimin e ligjit të pjesëmarrjes 50% të femrave në këshillin drejtues të qytetit, është diskriminues apo një nismë e nevojshme?*

E kam përmendur edhe në tryeza të tjera që vlen për tu përsëritur arritja e Aleancës së Grave Deputete dhe nismave të shoqërisë civile për finalizimin me sukses të misionit të tyre. Gjykoj që shoqëria shqiptare është në një nga fazat më të civilizuar përsa i përket angazhimit të femrës në sferën publike dhe politike. Këto nisma nuk duhet të mbeten me kaq, monitorimi i vazhdueshëm i situatës dhe nxitja për pjesëmarrje efektive jo numerike duhet të jetë në fokus të sfidave të radhës. Është kaq e rëndësishme që të monitorohet me sukses, që misioni të konsiderohet po i suksesshëm.

Në disa tryeza është përsëritur politika ime e punësimit që gjithnjë ka konsistuar në promovimin e figurës së femrës dhe pozicionim të saj në poste drejtuese, si dhe politikat sociale që kemi ndjekur në bashkinë Patos për të qënë më pranë grave, nënave, vajzave. Femrat punojnë më shumë, janë më pranë kërkesave të komunitetit dhe fitojnë më shumë besimin dhe zemrat e njerezve. Jam e prirur të besoj se me 50% e femrave në Këshill, do të jemi më të drejtë në vendim-marrje. Jam e bindur për këtë fakt. Kështu që nuk e shoh diskriminuese faktin e 50% të pjesëmarrjes së gruas në këshillat bashkiak, por një sfidë e arritur me dinjitet, por do të jetë më dinjitoze mënyra se si ato do të përfaqësojnë mendimin intelektual dhe profesional në vendim-marrje. Vendimet do të jenë më të drejta dhe me gjithë-përfshirëse. Misioni i gruas nuk është të garojë me shpirtin mashkullor, por të shpalosi botën femërore.

***Një çështje sociale që është me e afërt me zemrën tuaj?***

Në fakt janë disa, janë kryesisht çështje që lidhen me mirëqënien e familjes, kushtet minimale të jetesës dhe integritetin ekonomik brenda standarteve që priremi të kemi. Më besoni, është kaq e vështirë të vendosësh prioritete të çështjet sociale, por rastet që më kanë prekur zemrën janë gratë kryefamiljare me një apo më shumë fëmijë, të cilat nuk kanë një strehe, nuk kanë një punë apo burime të tjera të ardhurash. Banesat sociale për gratë kryefamiljare është një nga projektet që kemi punuar me gjithë zemër dhe do të përpiqemi maksimalisht për ta vënë në zbatim. Për këtë kërkoj ndjeshmërinë dhe mbështetjen e organizmave të tjerë që janë më pranë kësaj çështje dhe kësaj kategorie.

***Çfarë është, sipas jush roli i medias në edukimin e shoqërisë? A besoni se pasqyrimi gjerësisht i lajmeve politike është në të mirë të shoqërisë apo ato duhet të reduktohen?***

Mediat sot, si ajo vizive dhe e shkruar “gatuajnë” aq shumë, sa ti mund të zgjedhësh çfarëdo për të shijuar. Shqipëria është e vogël dhe realisht bëhet politikë. Ndoshta në këto vite trazicioni ende nuk kemi kultivuar brenda vetes kulturën e të ndjekurit atë për të cilën vërtetë kemi nevojë. Gjykoj se media luan një rol të rëndësishëm në edukimin e shoqërisë nëse ajo pasqyron saktë dhe drejtë realitetin, por dhe në shumëllojshmërinë dhe cilësinë e informacionit që ajo ofron. Media është e nevojshme për të shprehur dhe për të transmetuar gjithçka ndodh, por do të vija theksin në rëndësinë që të hiqet dorë nga komercialiteti, përsëritja, klientelizimi dhe cilësia e dobët. Publiku është i mirë-informuar, aq më tepër në një kohë kur media sociale të ushqen me informacion të vazhdueshëm, por gjithnjë duhet të garohet për cilësi. Publiku duhet respektuar.

***Ku duhet të përqëndrojë përpjekjet e saj për një ndryshim pozitiv, shoqëria shqiptare?***

Shoqëria shqiptare gjatë viteve të tranzicionit ka pësuar ndryshime të thella, më së shumti në mëndesi, mentalitet, në botë-kuptim. Breza që ndryshojnë shumë nga brezi tjetër dhe që nuk transmetojnë shume,

duke krijuar barriera midis tyre. Tjetërsimi i shoqërisë në një kohë kaq të shkurtër ka pasojat e veta sociale që prekin të gjitha sferat e shoqërisë, e kjo duhet shmangur. Përpjekjet e vazhdueshme për një ndryshim pozitiv të shoqërisë shqiptare duhen të lidhen me edukimin, kulturën, që brezi i ri për më tepër duhet të kultivojë dhe transmetojë.

Shoqëria civile e organizuar luan një rol të rëndësishëm dhe kjo kërkon delikatesë në trajtim dhe vëmëndje. Nuk duhet anashkaluar aspak rëndësia që i duhet dhënë faktorit social në promovimin e vlerave shoqërore të një kombi.

Sistemi arsimor i deritanishëm më së shumti po prodhon një brez dhe një shoqëri jo me merita dhe jo të aftë për të përballuar sfida të emancipimit dhe zhvillimit të shoqërisë për një stad jetese më të lartë. Ndaj reformat në sistemin arsimor duhen perçuar me tej dhe duhen mbështetur nga të gjithë faktorët që sot kanë në dorë fatet e zhvillimit të shoqërisë për të ardhmen.

### ***Kush janë gratë dhe burrat që ju kanë frymëzuar më shume?***

-Zonja e hekurt, Margaret Thatcher, që njihet për politikën e saj pa kompromis.

-Hillary Clinton, një grua me sharm dhe një zë i rëndësishëm në politikën amerikane. E guximshme për të propozuar dhe udhehequr reforma në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe sigurimeve shoqërore ku dhe përfituesit më të mëdhenj në këto nisma janë fëmijët dhe grate. Zonja e parë amerikane që guxoi të kandidojë për poste publike.

-Barack Obama, një vizion frymëzues mbi mundësitë e pafundme të së nesërme. Etalon i politikës së re.

-Edi Rama, piktori që ndryshoi drejtimin e zhvillimit të kryeqytetit tonë dhe sot nxitesi dhe orientuesi i hartimit të politikave progresiste në zhvillimin e Shqipërisë. Njeriu që i jep jetë nismave progresiste për rritjen e rolit të gruas në vendim-marrje dhe në drejtim.

Por unë jam e prirur që të më frymëzojnë edhe gjëra më të thjeshta, një grua që me përkushtimin e saj, guximin, arrin të pozicionohet qartë në ambicjen e saj dhe lufton për më shumë, një ekonomist profesionist që me idetë e tij i jep jetë ekonomisë së një biznesi apo më gjerë, një profesor që gjatë gjithë jetës së tij nuk lodhet për të dhënë dhe nxjerr breza të tërë të aftë profesonalisht.

Prindërit e mi që edhe pse në kushte jo të favorshme luftuan shumë për edukimin dhe arsimimin tonë.

## EVIS KUSHI

nga Irena Shabani

Evis Kushi është deputete e Kuvendit të Shqipërisë për Partinë Socialiste. Para se të merrte mandatin e deputetes ajo ka shërbyer si pedagoge në Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin "Aleksandër Xhuvani" në Elbasan. Ajo dallon për një stil racional dhe të qartë mendimi. Vlerëson rolin e politikës, atë të medias dhe mbështetjen e saj më të madhe prej nga merr frymëzimin e përditshëm, ka familjen e saj.

*Pse u përfshitë në politikë? Cilat janë sfidat tuaja personale? Cilët janë mbështetësit tuaj dhe cilët janë kundërshtarët tuaj?*

Unë hyra në politikë për herë të parë në vitin 2013, pas një eksperiencë 15-vjeçare në fushën akademike si pedagoge në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Elbasanit. Deri atëherë i trembesha agresivitetit dhe problematikave të shumta të politikës shqiptare, por më pas iu përgjigja pozitivisht ftesës së Partisë Socialiste me bindjen që ne të gjithë duhet të japim sa më shumë kontribut aty ku është e nevojshme. Përveç kësaj, përfshirja në politikë është një eksperiencë e re, shumë e veçantë, që pasuron njohuritë në shumë fusha si dhe aftësitë profesionale dhe komunikuese me njerëzit në përgjithësi. Sfida ime kryesore është që t'i përmbush me korrektesë të gjitha detyrat e mia si deputete, t'i përfaqësoj sa më mirë interesat e qytetarëve të Elbasanit dhe t'u vij atyre në ndihmë sa më shumë të jetë e mundur për nevojat dhe shqetësimet që kanë. Janë pikërisht qytetarët e Elbasanit mbështetësit e mi më të mirë, janë ata që më kanë besuar dhe votuar për të qenë zëri i tyre në organin më të lartë ligjvënës. Ndërkohë, lidhur me fundin e pyetjes, në aspektin personal unë nuk njoh ndonjë kundërshtar dhe nuk konsideroj asnjë të tillë. Ndërsa, si përfaqësuese e maxhorancës, unë vlerësoj si kundërshtarët tanë më të rrezikshëm korrupsionin, informalitetin, trafiket, kriminalitetin apo shkeljet e ligjit, prandaj kjo duhet të jetë në fokusin kryesor të punës tonë dhe lufta ndaj tyre duhet të jetë çdo ditë e më e ashpër.

***Cili është mendimi juaj për zhvillimet politike në Shqipëri?***

Situata politike në Shqipëri nuk ka qenë asnjëherë e qetë, por me ulje ngritjet e veta gjithmonë ka patur zhvillime, debate dhe polemika, madje ndonjëherë tepër të mprehta. Megjithatë, unë mendoj që kjo është normale në një vend demokratik sepse i nxit të gjitha palët që të jenë më serioze dhe më të përgjegjshme në aktivitetin e tyre politik. Por shpeshherë mua më vjen keq që politika në Shqipëri harxhon më shumë kohë dhe energji me akuza personale, sharje, shpifje, dhe jo me punë konkrete, shkëmbim idesh dhe opinionesh për politika më rezultative dhe efçente në fusha të ndryshme. E kam fjalën sidomos gjatë dy viteve të fundit, gjatë të cilëve vendi është përfshirë në një proces të rrënjësishëm reformash dhe ligjesh të rëndësishme në shumë fusha, por që debati politik ka qenë më shumë i fokusuar në "beteja" aspak produktive e aspak konstruktive midis palëve.

***Çfarë do të ndryshojë në Shqipëri në katër vitet e ardhshme? Cilat janë përparësitë kryesore të Shqipërisë dhe sfidat?***

Unë nuk mund të parashikoj çfarë do të ndryshojë në dy apo katër vitet e ardhshme, por unë mund të theksoj se çfarë DUHET të ndryshojë. Janë pikërisht ato sfida që përmenda më sipër, lufta kundër korrupsionit, informalitetit, reforma në drejtësi, në arsim, e në të gjitha fushat e jetës. Një prioritet shumë i rëndësishëm është punësimi, sidomos për të rinjtë e të rejat, të cilëve duhet tu ofrohen më shumë mundësi dhe mbështetje pas arsimimit apo formimit të tyre profesional. Jam e lumtur që ky është një ndër prioritetet kryesore të qeverisë aktuale, janë bërë hapa konkretë, ka shumë projekte në proces, dhe unë uroj dhe shpresoj shumë që rezultatet të jenë sa më të prekshme për rininë shqiptare.

***Çfarë mendoni për barazinë gjinore në Shqipëri? Si e shihni zbatimin e ligjit të pjesëmarrjes 50% të femrave në këshillin drejtues të qytetit, është diskriminues apo një nismë e nevojshme?***

Përsa i takon barazisë gjinore pa dyshim që në Shqipëri ka shumë problematika, të cilat aktualisht janë në fokus të punës për shumë institucione kombëtare, ndërkombëtare, shoqata të ndryshme, shoqërinë

civile etj. Për fat të keq, çdo ditë dëgjojmë në media raste ekstreme të dhunës ndaj grave, abuzime të rënda në familje, madje deri edhe në vrasje të nënave të reja dhe me pasoja të rënda për fëmijët dhe të gjithë anëtarët e familjes. Por sigurisht që këto janë probleme që nuk zgjidhen dot as për disa muaj, e as për disa vite, sidomos kur bëhet fjalë për çështje që janë të rrënjosura thellë në mentalitet apo në zakone brez pas brezi. Megjithatë duhet theksuar që ka një ndërgjegjësim pozitiv në rritje dhe progres të konsiderueshëm gjatë viteve të fundit. Sot gratë janë më të angazhuara në politikë dhe vendimmarrje, kemi më shumë gra ministre, deputete, drejtuese institucionesh, etj. Sot madje gratë janë edhe më të fuqizuara dhe më të pavarura nga ana ekonomike, sidomos në qytetet e mëdha. Arritja më e fundit, miratimi në parlament i ligjit për pjesëmarrjen 50% të grave dhe vajzave në këshillat bashkiakë, është një hap shumë i rëndësishëm në këtë drejtim. Unë personalisht e konsideroj si një nismë shumë pozitive dhe shumë të nevojshme për kushtet aktuale, por që duhet të jetë e përkohshme, deri në arritjen e disa niveleve apo standarteve të kërkuara në kuadër të barazisë gjinore në Shqipëri.

### *Një çështje sociale që është më e afërt me zemrën tuaj?*

Së pari, mbështetja për fëmijët jetimë mbetet gjithmonë një çështje sociale shumë sensitive, për të cilën duhet bërë shumë më tepër nga të gjithë. Unë si deputete e Elbasanit jam përpjekur të organizoj disa aktivitete për fëmijët jetimë në këtë qytet, ku qëllimi ka qënë jo thjeshtë ndarja e dhuratave apo ndihmave të ndryshme për ta, por sidomos sensibilizimi i të gjithë shoqërisë që këta fëmijë kanë nevojë për më shumë mbështetje dhe sidomos më shumë ngrohtësi dhe dashuri nga njerëzit që i rrethojnë. Dhe së dyti, një çështje sociale shumë e rëndësishme është punësimi i të rinjve, që siç e përmenda më sipër është një prioritet i padiskutueshëm, sidomos në kushtet aktuale të vendit.

### *Çfarë është, sipas jush roli i medias në edukimin e shoqërisë? A besoni se pasqyrimi gjerësisht i lajmeve politike është në të mirë të shoqërisë apo ato duhet të reduktohen?*

Media ka një ndikim tepër të lartë në edukimin e shoqërisë, sidomos në ditët tona kur edhe përmirësimi i teknologjisë bën që ne të gjithë të jemi



në kontakt me lajmin në çdo vend dhe në çdo kohë. Sigurisht që pasqyrimi i lajmeve të rëndësishme politike është i nevojshëm në mënyrë që njerëzit të informohen, të ndërgjegjësohen dhe të mbajnë qëndrimet e tyre, duke reaguar në mbështetje apo kundër politikave apo vendimeve të ndryshme që ndikojnë në jetën e tyre. Por, mua nuk më shqetëson shumë sasia e tyre sesa më shqetëson vërtetësia, pra mediat në përgjithësi duhet të jenë shumë profesioniste dhe të pavarura për t'i pasqyruar lajmet me korrektesë, vërtetësi dhe paanshmëri, duke mos u vënë në shërbim të partive politike. Në këtë mënyrë do të jetë më realiste dhe me vlerë edhe vota e qytetarëve, si për zgjedhjet parlamentare ashtu edhe ato vendore.

***Ku duhet të përqëndrojë përpjekjet e saj për një ndryshim pozitiv, shoqëria shqiptare?***

Kjo është një pyetje shumë e gjerë, sepse shoqëria shqiptare mund dhe duhet të japë kontribut në të gjitha fushat e jetës. Por për momentin, duke njohur situatën aktuale në Shqipëri, unë mendoj se përpjekjet kryesore duhet të përqëndrohen në luftën kundër korrupsionit. Kjo luftë është e pamundur të fitohet pa mbështetjen dhe bashkëpunimin e të gjithë shoqërisë. Nëse ne minimizojmë korrupsionin në drejtësi, tatim-taksa, dogana, arsim, shëndetësi, e kudo tjerër, atëherë rezultatet do të jenë në dobi të të gjithëve dhe Shqipëria do të jetë shumë më afër Bashkimit Europian.

***Cilët janë gratë dhe burrat që ju kanë frymëzuar më shumë?***

Në fakt janë shumë dhe mund të jenë të ndryshëm në periudha të ndryshme të jetës, në varësi të punës, në varësi të vështirësive dhe sfidave të momentit. Ndonjëherë kanë qenë profesorët e mi, ndonjëherë miq shumë të afërt, ndonjëherë personalitete të famshëm botërorë, por ajo që më frymëzon më shumë, në çdo kohë, në çdo vend, në çdo sfidë, është familja ime, është mbështetja më e madhe që kam, është frymëzimi më i bukur që kam për çdo hap që hedh në jetë.

## **NUSHE HOXHA**

nga Irena Shabani

Ë përfshirë në politikë që në orët e para të lëvizjeve demokratike, Nushe Hoxha ka mbetur po njësoj, idealiste dhe e drejtë. Në gjithë këto vite demokraci ajo është përballur jo vetëm me elektoratin, por edhe me mendimet e saj për të analizuar premtimet politike. Ë thjeshtë dhe e drejtë, ajo beson se vendi është në fazën kur duhet të ndryshoj kurs. Sfidat e Shqipërisë sipas saj janë të mëdha, aty përfshihen që nga reforma në drejtësi dhe deri te ndryshimet që duhet të bëhen në arsimin shqiptar. Ajo beson se pa njerëz të denjë, ky vend nuk ka të ardhme.

***Pse u përfshitë në politikë? Cilat janë sfidat tuaja personale? Kush janë mbështetësit tuaj dhe cilët janë kundërshtarët tuaj?***

Ëndrra ime ka qënë gjithmonë të jem aktive dhe që kur kam qënë e vogël unë e kam parë veten si lidere, pra në një grup kisha qejf që t'u prija. Por që fëmijë dhe derisa të mbyll sytë, kam qënë e drejtë dhe gjithmonë kam dashur t'u bëj mirë të tjerëve dhe t'u vij në ndihmë njerëzve në nevojë. Besimi dhe drejtësia është virtyti im të cilën e kam dhuratën më të mirë nga prindërit e mi. Në vitet '90 jam përfshirë në lëvizjen demokratike dhe anëtarësuar në PD. Ëndrra evropiane dhe integrimi i Shqipërisë janë dy ëndrrat me te bukura të shpirtit tim, nuk kam pushuar së punuarit ndershëm dhe duke kritikuar hapur brenda Lidhjes Demokratike të Gruas Shqiptare dhe brenda Partisë Demokratike për të gjitha gjërat që nuk kanë ecur mirë, kam luftuar pa kompromis në çdo tryezë. Jam trajnuar në shumë fusha dhe kam kryer një master të Universitetit të Montrealit të Kanadasë për Menaxhimin dhe Drejtimin e Shëndetit Publik për të dhënë kontributin tim maksimal në sektorin ku punoj. Mbështetësit e mia më të mira në Partinë Demokratike janë anëtarët e Lidhjes Demokratike të Grave. Kundërshtarë realë nuk kam pasur, më kanë parë si të tillë të gjithë ata që më kanë ndjerë si kandidate për t'i zëvendësuar në strukturat partiake.

***Cili është mendimi juaj për zhvillimet politike në Shqipëri?***

Energjitë e harxhuara gjatë këtyre 25 viteve nga politika nuk kanë qënë produktive në të shumtën e rasteve. Në nje çerek shekulli duhej të bëhej

më shumë, ëndrra evropiane e shqiptarëve mbetet akoma e parealizuar. Gjatë katër viteve të ardhshme mendoj se në Shqipëri politika duhet të zbatohet dhe të realizohet të gjitha detyrat e BE, të zgjidhen njerëzit më të mirë të cilët me performancën dhe integritetin e tyre të jenë modeli më i mirë për shoqërinë shqiptare, njerëz me përvojë, të suksesshem që e dinë si mund të bëhet Shqipëria. Sepse përvoja e këtyre viteve ka treguar të kundërtën.

*Çfarë do të ndryshojë në Shqipëri në katër vitet e ardhshme? Cilat janë përparësitë kryesore të Shqipërisë, cilat janë sfidat?*

Sfida më e madhe që duhet vënë në zbatim është reforma në drejtësi. Një sfidë tjetër është lufta pa kompromis kundër korrupsionit në të gjitha nivelet, duke filluar nga lart e deri në bazë, reforma zgjedhore dhe përzgjedhja e njerëzve të shkolluar në Perëndim dhe që kanë eksperiencë të vendeve të suksesshme të botës, njerëz me rezultate dhe eksperiencë më të mirë brenda vendit, për të gjitha nivelet, në pushtetin legjislativ, ekzekutiv, gjyqësor, liria në media dhe në administratën publike.

Realizimi i detyrave të caktuara nga BE dhe integrimi i Shqipërisë është një tjetër sfidë për ne. Reformat evropiane dhe jo partiake të arsimit janë baza e standardeve afatgjata të suksesit dhe perspektivave evropiane të Shqipërisë. Hartimi i projekteve në të gjitha fushat për të thithur projekte nga të gjitha organizatat ndërkombetare për të zbutur varfërinë dhe për të kthyer shpresën e humbur se “Ne Mundemi”, se Shqipëria bëhet është një tjetër prioritet, ashtu siç është hartimi i strategjive konkrete dhe të zbatueshme të zhvillimit të turizmit në të gjitha stinët nga veriu në jug. Pikë tjetër është mirëadministrimi i pasurive kombëtare.

*Çfarë mendoni për barazinë gjinore në Shqipëri? Si e shihni zbatimin e ligjit të pjesëmarrjes 50% të femrave në këshillin drejtues të qytetit, është diskriminues apo një nismë e nevojshme?*

Kjo arritje ishte rezultati i shumë viteve punë të kryer gjatë këtyre viteve, rezultatet janë të konsiderueshme dhe perspektiva në të ardhmen është e sigurtë, e bazuar në një kuadër të fortë ligjor. E shikoj këtë ligj si sfidë

dhe domosdoshmëri në kushtet tona, dhe zbatimin e tij e shoh si risi që sjell shumë përparësi, pasi femrat janë shumë korrekte dhe nuk bëjnë kompromise të mbrapshta, femrat janë të kujdesshme, sociale, integruese dhe të vendosura për t'u shkuar punëve deri në fund.

*Cila çështje sociale është më pranë zemrës tuaj?*

Problemet sociale, fëmijet jetimë, komuniteti rom, zonjat e dhunuara, kryefamiljare, si dhe moshja e tretë. Mendoj se kam punuar me shpirt në çdo cep të Shqipërisë në mënyrë vullnetare pa u lodhur, me Fondacionin "Fëmijët Shqiptarë". Unë besoj se strumbulluari i të gjitha krimeve e ka bazën te varfëria e tejskajshme. Varfëria e zhvesh njeriun nga dinjiteti. Edhe arsimit është pika ime e dobët. Arsimit ka mbetur shumë pas dhe është kthyer në një mall, nuk është më një prioritet, prej aty fillon dështimi kryesor.

*Cili është sipas jush roli i medias në edukimin e shoqërisë? A besoni se pasqyrimi gjerësisht i lajmeve politike është në të mirë të shoqërisë apo ky fenomen duhet të reduktohet?*

Media si pushteti i katërt ka rëndësi vendimtare, por duhet të ishte e pavarur. Nuk he nuk ka gjë më të dhimbshme se kur liria e fjalës dhe shtypi ndahet në dy krahët e politikës, në vend që të jetë në krah të integritetit dhe të qytetarëve. Mediat duhet të vënë në dukje ç'do gjë që nuk shkon mirë, çdo të metë të pushtetit. Ato duhet të vënë në dukje problemet në çdo cep të Shqipërisë dhe të mos mbyllën në Tiranë. Mediat duhet të vënë në dukje dhe të luftojnë korrupsionin në të gjitha nivelet, të sjellin në kronikat e tyre njerëz të suksesshëm dhe të bëhen modelet ku rinia të motivohet. Mediat nuk duhet të promovojnë njerëzit që bëhen të famshëm e të pasur brenda natës. Rruga e gjatë, por e pakthyer mbrapa e pushtetit të katërt është sfida vendimtare e pasqyrimin të realitetit shqiptar. Në plan të parë duhet të vendosen prioritetet kombëtare, gënjeshtrat dhe modeli i shëmtuar i politikës duhet të kalojë në plan të dytë, vetëm atëherë mendoj se edhe në Shqipëri gjërat do të ndryshojnë.

***Ku duhet t'i përqëndrojë përpjekjet e saj për një ndryshim pozitiv shoqëria shqiptare?***

Sfida jonë më e madhe është edukimi i brezit të ri dhe krijimi i modeleve që tu japin tu kuptojnë të rinjve se edukimi, puna dhe drejtësia janë baza e çdo suksesi afatgjatë. Kthimi i shpresës së humbur se Shqipëria bëhet kur secili kontribuon me punën e tij. Jam shumë optimiste dhe me energji pozitive, shpresoj shumë tek njerëzit që i kanë thënë STOP të gjitha gjërave që na kanë penguar një çerek shekulli për të qenë në BE. Shoqëria civile duhet të jetë aktive, sepse përvoja e këtyre viteve ka treguar se kur ka vepruar ka qenë e suksesshme dhe ka plot njerëz integritet të cilët nuk janë konsumuar gjatë këtyre 25 viteve. Figura të reja dhe të panjolllosura duhet të marrin përgjegjësi për fatet e kombit.

Jam edukuar dhe frymëzuar që të jem e drejtë, humane, kërkuese ndaj vetes për të qenë integruese dhe bashkëkohore, për të qenë e suksesshme me kontributin tim se Shqipëria bëhet nga secili prej nesh, për të thënë fjalën time hapur, për të luftuar për demokratizimin e forcës politike ku aderoj. Jam e gatshme për të mbajtur fjalën e dhënë dhe duke luftuar pakompromis korrupsionin në ç'do fushë.

***Cilët janë gratë dhe burrat që ju kanë frymëzuar më shumë?***

Familja ka qenë gjithmonë baza dhe modeli i frymëzimit tim. Në politikë më frymëzojnë zonjat Jozefina Topalli, Albana Vokshi dhe Grida Duma. Por veçanërisht zonja Liri Berisha. Kam qëndruar pranë asaj gruaje duke punuar vullnetarisht në fondacionin e drejtuar prej saj. Kurrë nuk e pashë ta trajtonte veten si grua kryeministri, kurrë nuk kërkoi favore në emër të tij.

## **FELEK BRAHIMI**

nga Irena Shabani

Ajo vjen nga Shkodra - një qytet që rrezaton traditë, besnikeri, ideale. I pëlqen politika, jo ajo e rëndomta, jo politika e mbushur me publicitet dhe slogane. I pëlqen politika ndryshe, ajo që sjell vlera dhe u shërben qytetarëve - një urë lidhëse mes atyre që mendojnë djathas, atyre që mendojnë majtas dhe atyre që të mbushur me zhgënjim nuk preferojnë asnjërën palë.

Politika duhet tu shërbejë njerëzve dhe disa shembuj të mirë në politikën e bashkëpunimit i sjellin gratë. Ajo kështu beson dhe kështu shpreson të bëhet. Gjatë viteve të fundit Feleku ka vërejtur se politika është zbutur; ajo beson që idetë e grave brenda çdo partie politike e rrisin realisht numrin e votave. Ajo sheh se tashmë rritja e pjesëmarrjes së grave ka kapërcyer paragjykimet, ku mentaliteti sundonte logjikën.

*Pse u përfshitë në politikë? Cilat janë sfidat tuaja personale? Cilët janë mbështetësit tuaj dhe cilët janë kundërshtarët?*

Në politikë kam hyrë natyrshëm, por përfshirja reale erdhi në vitin 2010 në "Programin për zhvillim dhe decentralizim" ku bëja pjesë së bashku me tri gra të tjera këshilltare - Nirvana Lekaj, Irma Kopliku dhe Aferdita Haka.

*Cili është mendimi juaj për zhvillimet politike në Shqipëri?*

Me qëllim rritjen e përfaqësimit të grave në politikë krijuam rrjetin e grave në vendim-marrje dhe forumin për rolin e gruas në politikbërje ku u përfshinë Lezha, Malësia e Madhe, Rubiku dhe Puka. Politika për mua duhet të jetë e butë dhe gratë mund ta sjellin këtë frymë. Në vitin 2001 isha këshilltare për Partinë Socialiste në bashkinë e qytetit, ndërsa që prej tetorit të vitit 2013 jam sekretare e përgjithshme në prefekturë. Për të hedhur këto hapa më ka mbështetur familja si edhe partia ku aderoj.

*Çfarë do të ndryshojë në Shqipëri në katër vitet e ardhshme? Cilat janë përparësitë kryesore të Shqipërisë dhe sfidat?*

Sfidat janë të shumta, ndërkohë që sipas meje diçka e madhe tashmë është arritur, - ndarja e re territoriale. Ajo do të mundësojë që qeveritë

vendore të jenë më të koncentruara dhe të mbajnë më shumë përgjegjësi. Para kësaj stafet nuk ishin të kualifikuara dhe nuk punonin në unison.

***Çfarë mendoni për barazinë gjinore në Shqipëri? Si e shihni zbatimin e ligjit te pjesëmarrjes 50% të femrave në këshillin bashkiak - është diskriminues apo një nismë e nevojshme?***

Aleanca e grave parlamentare vlen të vlerësohet shumë, ishin ato që ushtruan presion mbi burrat për të arritur në këtë pikë. 2 prilli do të mbetet një datë e rëndësishme, sepse u kapërcye sfida më e madhe dhe u arrit 50 përqindëshi i përfaqësimit.

Gruaja luan një rol shumë pozitiv, sepse po të vihet re kur stafi përbëhet nga shumë gra ato janë të duruara për ta filluar dhe çuar deri në fund dicka. Mjafton të vëmë re që në parlament është ulur niveli i fyerjeve, i fjalorit banal. Burrat janë më të kujdesshëm në prani të grave dhe në këtë mënyrë ata "edukohen" dhe në seancat parlamentare nuk shfaqin nivele të ulëta të dialogut dhe në njëfarë mënyre nuk e ndotin veshin e publikut.

Diçka që dua ta përmend patjetër përsa i takon frymës pozitive është fakti që në Shkodër në zgjedhjet e qershorit të këtij viti garonin dy femra. Atmosfera dhe sulmet e egra politike siç ka ndodhur në vitet e tjera zgjedhore mungonte dhe për herë të parë pas kaq vitesh pluralizëm zonja Keti Bazhdari dhe zonja Voltana Ademi kanë dalë dhe janë përballur me pyetjet e të rinjve, të dyja në të njëjtën tryezë. Kjo është shenjë e madhe qytetarie, shenjë që duhet të fillonte patjetër nga femrat!

***Një çështje sociale që është me afërt me zemrën tuaj?***

Si njeri i arsimit më afër zemrës kam shkollat, duke filluar që nga infrastruktura deri tek edukimi. Një shoqëri e shëndetshme dhe një popull i mirëarsimuar e ka të ardhmen e sigurtë. Ajo që për mua është e gabuar ka të bëjë me programet arsimore që në këndvështirimin tim janë të mbingarkuara. Nga ana tjetër jo gjithkush që ka diplomë për mësuesi mund të krijojë tekste dhe të pretendojë që ato vlejné për tu

përdorur në mësim-dhënie. Duhet të krijohen tekste nga grupe autorësh të mirëdiplomuar dhe që kanë çfarë tu ofrojnë nxënësve, librat thjeshtë për fitim-prurje duhet të zhduken nga bankat e shkollës.

*Cili është, sipas jush roli i medias në edukimin e shoqërisë? A besoni se pasqyrimi i lajmeve politike është në të mirë të shoqërisë apo ato lajmet duhet të reduktohen?*

Media vlen shumë, ajo mund të jetë një armë në duart e politikës, ose një zëdhënëse për problemet e qytetarëve. Sipas meje lajmet politike duhet të reduktohen. Njerëzit nuk kanë nevojë të ushqehen me politikë se ata janë aq të ndërgjegjshëm sot sa e dinë mirë çfarë ka vlerë për ta dhe çfarë nuk ka. Problemet sociale duhet të pasqyrohen në atë mënyrë që të shkojnë në veshin dhe mëndjen e gjithsecilit, gjë që do të rrisë frymën qytetare dhe anëtarët e komunitetit do të fillojnë të bëjnë më shumë për atë që u përket të gjithëve.

*Ku duhet t'i përqëndrojë shoqëria shqiptare përpjekjet e saj për një ndryshim pozitiv?*

Ka ardhur koha për një qasje ndryshe, nëpërmjet shoqërisë civile. Njerëzit nuk duhet ta shohin politikën si të vetmen mënyrë për të ecur përpara. Shoqëria shqiptare duhet të çojë zërin për problemet që e shqetësojnë. Ajo duhet të jetë faktor, jo thjesht një zë demaskues.

*Cilat janë gratë dhe burrat që ju kanë frymëzuar më shumë?*

Në jetë njeriut i ndodh të njohë shumë njerëz nga të cilët mund të marrë dhe të përvetësojë atë që është më e mirë, atë që të ndihmon për të ecur përpara. Për mua shembulli më i madh i frymëzimit ka qënë babai im. Ai më mësoi se njeriu kur bën hapa para, nuk duhet kurrë të ndalojë në mes të rrugës dhe të kthehet mbrapsht. Sado e vëshirë të jetë rruga ai duhet t'i shkojë asaj deri në fund.



## ARJANA PUPA

nga Irena Shabani

Arjana Pupa është përfshirë në politikë që nga viti 2001. Arsyet pse ajo i ka hyrë kësaj rrugë janë të shumta, por e para dhe më kryesorja lidhet me besimin dhe dëshirën e saj për të bërë sadopak që ky vend të ecë përpara. Edhe pse sot nuk është aq entuziaste sesa ka qënë më shumë se një dekadë më parë.

Ka vërejtje, ndoshta si kushdo që e njeh realitetin nga brenda dhe kupton që atë nuk e ndryshojnë fjalët por faktet. Për 11 vjet me rradhë Arjana Pupa ka qënë anëtare e këshillit bashkiak për Partinë Demokratike në Bashkinë e Korçës. Ajo thotë se për t'u ngjitur deri aty ka punuar me forcat e saj, ndaj nuk është fort entuziaste për 50 përqindëshin e kuotës së barazisë gjinore për këshillat lokalë.

*Pse u përfshitë në politikë? Cilat janë sfidat tuaja personale? Kush janë mbështetësit tuaj dhe cilët janë kundërshtarët tuaj?*

Fillesat i kam në rininë e hershme, ku më pëlqente të bëhesha pjesë e dimensionit social të politikës, të isha aktive. Më vonë mësova se aftësitë e mia duhet t'i çoja me tej dhe ishin partitë politike ato që të jepnin shanse të tilla. Kam mësuar se gratë dhe burrat kanë aftësi të njëjta për të gjykuar dhe vepruar, zgjedhin të dy të veprojnë, e kanë njëlloj kurajon (apo mungesën e saj) për të vendosur synime dhe për të kapërcyer kufijtë. Nëse janë pothuaj njësoj, pse nuk mund të kenë njësoj vend dhe në politikë? Thua të jetë frika e sfidës? Kësaj pyetje jam munduar t'i kthej përgjigje me punën dhe përkushtimin tim. Them se ia kam arritur.

Cjithmonë më kanë shqetësuar problemet me të cilat përballen gratë në realitetin e sotëm, jo vetëm në jetën politike, por dhe në atë publike. Të merresh me politikë duhet të marrësh përsipër dhe risqe të cilat të shoqërojnë hap pas hapi. Konkurrenca dhe lufta brenda politikës është aq e ashpër sa duhet të jesh shumë e përgatitur për t'i përballuar. Cjithësesi jam munduar të ndikoj pranë partive politike për rritjen e pjesëmarrjes së gruas në vendimmarrje.

Them se nuk ka qenë gjithnjë e lehtë për mua. Jo gjithmonë kam patur mbështetje aty ku mendoja se mund të mbështetesha. Megjithatë them se më shumë gra i bëjnë mirë politikës. Kjo është e vetmja rrugë për të patur një shans më shumë. Edhe pse jo gjithmonë politikanët meshkuj dhe partitë politike i mbështesin.

Gratë ka më pak gjasa të kenë akses në këto baza pushteti tradicional. Prandaj sa më demokratike dhe sa më transparente të jenë operacionet e partive politike, aq më shumë akses do të kenë gratë në vendimmarrje. Kundërshtarët e mi kanë qenë gjithmonë ata që nuk i përballojnë dot gratë politikisht të përgatitura.

Por unë nuk kam hequr kurrë dorë për të thënë atë që kam menduar. Prandaj mendoj që sa më shumë gra të angazhohen pranë partive politike, aq më mirë do ta mbrojnë njëra-tjetrën. Shpresoj që brezat që vijnë të emancipohen politikisht për ti dhënë atë që meriton çdokujt qoftë burrë apo grua.

### *Cili është mendimi juaj për zhvillimet politike në Shqipëri?*

Partitë politike në Shqipëri janë marrë pothuajse vetëm me teorinë e pushtetit. Çka do të thotë se marrja dhe mbajtja e pushtetit është i vetmi qëllim ku drejtohen energjitë mendore dhe njerëzore të partive politike. Ndërkaq marrja e pushtetit duhet të jetë thjesht mjeti për të praktikuar një vizion politik për të mirën e përbashkët të kombit.

Demokracia si koncept është qeverisja e popullit, sipas vullnetit të tij. Kam mendimin se në vendin tonë demokracia ka rrugë të gjatë për të bërë. Duhet akoma punë për ta perceptuar drejt politikën, sepse është politika ajo që i çon votuesit tek kutitë e votimit. Por ajo duhet të ekzistojë edhe përtej marrjes së votës.

Duhet të kultivojmë kulturën politike, jo vetëm tek politikanët (edhe pse ata kanë nevojë të parët), por dhe tek masa e popullit.

Konkretisht politika është përfshirë në një vorbull. Partitë politike mundohen të sigurojnë "shumicën" duke e parë popullin si turmë.

*Çfarë do të ndryshojë në Shqipëri në katër vitet e ardhshme? Cilat janë përparësitë kryesore të Shqipërisë dhe sfidat?*

Klasa politike dhe paaftësia e saj për të hedhur tej politikën konfliktuale vazhdojnë të mbeten një nga problemet kryesore të Shqipërisë.

Korrupsioni, emërimet politike në administratë, mangësitë në reforma, krimi i organizuar, pastrimi i parave dhe trafiket janë "problemet serioze të Shqipërisë", sipas raportit të Komisionit Evropian për vendet që pretendojnë antarësim në BE. Shqipëria mbetet ende shumë larg BE-së. Sipas BE Shqipëria ka një klasë politike, e cila nuk arrin të shmangë konfliktet dhe që ende nuk ka miratuar një ligj për të kontrolluar financimet e partive, duke i lënë të hapura mundësitë për korrupsion brenda tyre. Klasa politike e cila zotohet të luftojë korrupsionin, vazhdon të mbetet, sipas raportit të fundit, problemi kryesor i Shqipërisë.

*Çfarë mendoni për barazinë gjinore në Shqipëri? Po për kuotat gjinore?*

Barazia e mundësive nuk është realizuar akoma. Për këtë arsye, vende me demokraci më të zhvilluar dhe traditë më të gjatë në çështje të barazisë gjinore, kanë futur mekanizmin e kuotës, si zgjidhjen më të mirë të mundshme.

Kur flasim për rritje të përfaqësimit të gruas në vendimmarrje, duhet të kemi parasysh dhe modelin e gruas që do të përfaqësohet në këto institucione. Këto gra duhet të jenë aktive në politikë dhe të kenë ndikim në partitë e tyre për të realizuar politikat gjinore, të jenë të gatshme të dëgjojnë problemet e grave dhe të mbrojnë interesat e tyre, të kenë aftësi menaxhuese dhe drejtuese, të ruajnë identitetin e tyre dhe të jenë të respektuara nga komuniteti. Jo rastesisht ekziston thënia: nëse do të vlerësosh demokracinë e një vendi, përparimin e një shteti dhe civilizimin e një shoqërie, shiko se çfarë vendi ka gruaja në to.

Thelbi i problemit qëndron tek partitë politike. Tani që kuotat e barazisë gjinore janë realizuar, shtrohet pyetja: A kanë vendosur partitë nëpër lista ato gra që e meritojnë vërtet të përfaqësojnë komunitetin në vendimmarrje? Nëse po, dhe nëse ato do të jenë të suksesshme, do të kemi një model të ri të emancipimit në Shqipëri.

***Një çështje sociale që është me afërt me zemrën tuaj?***

Për 8 vjet kam qenë në Komisionin e Ndhmës Sociale dhe Strehimit të Korçës ku kam parë nga afër nevojat sociale që kanë familjet në nevojë. Brenda hapësirave ligjore kam ndikuar në Këshill për të ndihmuar individët si nga fondi i Bashkise deri tek Qeveria. Vazhdoj ta bej dhe sot, sepse të ndihmosh njerëz në nevojë është jo vetëm humane, por dhe shpirtërore. U jam përkushtuar shumë dhe grave që rritin fëmijë jetimë.

***Cili është, sipas jush, roli i medias në Shqipëri? A besoni se pasqyrimi gjërësisht i lajmeve politike është në të mirë të shoqërisë apo ato duhet të reduktohen?***

Shoqëria shqiptare është thelbësisht e politizuar. E them këtë pasi një rol në mbipolitizimin e shoqërisë e luajnë dhe mediat. Kjo shoqëri mbingarkohet me emisione politike. Sot edhe televizionet kanë përkatësitë e tyre politike. Kujt i shërben kjo? Sigurisht vetëm partive politike. Por çdo gjë duhet të ketë masën e vet.

***Ku duhet ti përqendrojë shoqëria shqiptare përpjekjet e saj për një ndryshim pozitiv?***

Dihet që ne vijmë nga një shoqëri e cila ishte nën sistemin komunist dhe si e tillë ajo ka mbartur me vete dhe fenomene që në të shumtën e rasteve shfaqen dhe sot. Kjo e jona është një shoqëri e cila vazhdon të përballet me një tranzicion tej mase të gjatë.

Demokratizimi i mentalitetit shqiptar me sa duket do të jetë një nga sfidat më të vështira të shoqërisë.

## **SANIJE BATKU**

nga Irena Shabani

Sanije Batku është aktiviste e sprovuar e komunitetit të organizatave joqeveritare të Dibrës. Ka zgjedhur të punojë në një zonë ku ndoshta do ta kishte më lehtë për të bërë përpara me mbështetjen e ndonjë partie politike. Sanija preferoi të veprojë ndryshe sepse beson tek vlerat e komunitetit, tek forca me të cilën ai mund ta lëvizë para një vend.

### *Kur jeni aktivizuar në organizatat qeveritare?*

Kam punuar me organizatat joqeveritare që në vitin 1993. Puna në këtë sektor lidhet së tepërmi me komunitetin, në të gjitha drejtimet, me jetën shoqërore, familjare, sociale. Komuniteti është vendi ku njerëzit edukohen me frymën e bashkëpunimit, ku shteti, edhe pse mjaft i rëndësishëm, është thjesht njëri ndër partnerët dhe jo i vetmi aktor. Fatkeqësisht jemi mësuar tradicionalisht që çdo gjë të na e realizojë shteti. Nëse duhet një urë e bën shteti, nëse duhet një kopësht, e bën shteti.

E kam nisur bashkëpunimin tim me OSBE-në, në vitet 1998 dhe kemi arritur të organizojmë takime me gra nga Bulqiza, edhe nga fshatrat më të largëta. Dëshironim që gratë të merrnin pjesë dhe të kishin kurajo jo vetëm për të votuar të pavarura, por edhe për tu zgjedhur në organet drejtuese.

Në fillim nuk kishte gra që të merrnin përsipër detyra shoqërore dhe veçanërisht detyra politike. Nëse do të shkoje në mbledhjet e ndonjë partie politike mund të gjeje si anëtare një ose dy gra. Punuam shumë muaj që ato të ingranoheshin politikisht dhe të krijonin vetëbesimin e mjaftueshëm.

Nëpërmjet forumit të pavarur të grave trajtuam disa herë problemet e gruas në vendimmarrje dhe arritëm të lidheshim me një organizatë franceze. Në fillimet e demokracisë ishte e thuajse e pamundur të bashkoje gra të forcave të ndryshme politike. Sfida përballë nesh ishte vërtet e madhe.

***Kur e themeluar forumin e pavarur të gruas në qytetin tuaj?***

Fillimisht në vitin 1993 kur u bënë zgjedhjet e dyta demokratike ne e formuam si forum të pavarur me të gjitha gratë e forcave politike. Fillimisht unë isha në krye të këtij forumi, por më vonë u tërhoqa dhe vazhdova me rolin e kordinatores. Në krye të këtij forumi u zgjodh një grua tjetër e cila kontribuoi së tepërmi në mbarëvajtjen e tij. Por fryma e bashkëpunimit mori fund shumë shpejt, sepse gratë e Partisë Demokratike nuk do vinin më në takimet e ardhme dhe mua mu tha që mospjesëmarrja e tyre në forum ndodhte me urdhër nga lart. E njëjta gjë ndodhi edhe me gratë nga Partia Socialiste. Mbetëm shumë pak vetë. Megjithatë edhe pse e ngritur me shumë vështirësi sidomos në rrethet e largëta, puna me ka shumë pluse, pasi ndryshimi, i cili është i vështirë për t'u arritur, është gjithashtu më i vështirë për tu çbërë. Reputacionin e kishim të mirë. Çfarëdo problemi që kishte komuniteti, mundoheshim ta zgjidhnim paanshmërisht.

Në vitin 1996 Rolanda Dhimitri siguroi ndihma në miell. I çuam nëpër magazina. Zgjodha dy zonat më të varfra dhe ua shpërndamë të gjithëve, kjo shtoi besimin tek ne dhe njerëzit filluan të afrohen. Nëse do kisha qënë e vetme nuk do ia dilja dot. Filozofia e donatorëve është që të kesh partner, sepse kështu mëson prej tyre dhe ata prej teje.

***Çfarë mendoni ju që ka ndryshuar në këto vite të vështira deri në ditët tona. Çfarë ka ndryshuar në mentalitetin e femrës për sa i përket frymës së bashkëpunimit, pavarësisht cilit kah politik i përket?***

Në ditët e sotme, jam e sigurt se pavarësisht përkatësisë politike, gratë e Dibrës nëse do të thirren ne një takim nga një organizatë si OSBE-ja, do të vijnë pa përjashtim. Kështu ndodhi dhe në takimin e fundit në pranverë të vitit 2015. Kjo që them tregon një ndryshim mentaliteti sepse diçka e tillë ishte e pamundur më parë. Në legjislaturën e kaluar kishim edhe një projekt për gratë në vendim-marrje, dhe një pjesë prej tyre nuk erdhën me pretekse nga më të larmishmet. Por kësaj here situata ishte ndryshe.

Në çdo legjislaturë ka zhvendosje mentalitetesh, besoj që kjo ka të bëjë edhe me bashkimin e grave deputete në një tryzë të përbashkët, një shembull ky për tu vlerësuar dhe ndjekur.

*Çfarë mendoni për 50 përqindëshin? Përfshirja e një numri kaq të madh femrash në këshillat bashkiakë për herë të parë mos vallë do të thotë që ka pak diskriminim dhe ndoshta për shkak të numrit të madh, jo domosdoshmërisht prurja e tyre do të jetë cilësore?*

Problemi i pjesëmarrjes së grave ekzistonte që në fillim. Në forumet partiake pjesëmarrja e grave ishte shumë e ulët, gratë stepeshin, por edhe burrat nuk e kishin në mendje t'i vinin në lista. Ua kam thënë shumë njerëzve, nëse një burrë që është në krye të një partie, ka si bashkëshorte një grua intelektuale do të dijë t'i vlerësojë më mirë gratë që marrin pjesë në forumet partiake.

*Mund të degradojë pjesëmarrja në cilësi?*

Ekziston kjo mundësi, pasi ka patur raste kur nëpër këshilla janë përfshirë gra që ndoshta nuk janë më të mirat, por është pozitiv kushti i pjesëmarrjes prej 50 përqind, është bërë një hap shumë i madh përpara.

Vënia e 50 përqindëshit edukon në radhë të parë forumet partiake, pastaj edukon edhe gratë. Kjo grua që do vihet në këtë këshill bashkiak sikur 5 përqind të flasë për problemet e grave në shoqëri, do të arrijë një hap shumë pozitiv në zhvillimin përpara. Nëse pjesëmarrjen e grave do ta linim në dëshirën e forumeve partiake, do të ecnim kështu gjithë jetën. Gjithmonë ka qenë kështu. Në mungesë të veprimit asgjë nuk ndodh. Po ju sjell një shembull: Në kohën e monizmit isha kryetare e gruas për rrethin e Dibrës. Sekretari i parë i Partisë vuri re që nuk kishte femra në drejtim. Ai i kërkoi sekretarit të parë për kuadrin që të sillte një liste me emra femrash që vlenin për të qënë në poste drejtuese.

Përgjigjja e tij ishte: nuk ka gra. Kjo zonë nuk ka, kjo jo, as tjetra. Një ditë sekretari i parë më pyeti dhe unë i pohova që ka plot femra që vlejné. I bëra një listë me mbi 50 emra grash që vlenin, si drejtoresha shkollash, spitalesh apo kooperativash. Pasi pa listën ai i pohoi se këto gra vlenin, por nuk i kishin rënë në mend. Ndoshta ky fenomen do të vazhdojë të ndodhë përsa kohë burrat do të vazhdojnë të matin gratë në karrierë me kutin me të cilën matin gratë e tyre.

***Si ju duket marrëdhënia e një vendi si yni me median? Sa janë të përfaqësuar qytetarët?***

Dua që politika të mos shfaqet kaq shumë, mua më krijon stres, media duhet t'i japi këto takime, po jo në të gjithë oraret e lajmeve, sepse krijon një stres të tillë që njeriu nuk e përballon dot. Në vitin '92 na erdhi për vizitë një zonjë amerikane dhe më pyeti si është rinia tek ju, përdorin drogë, alkool? Pasi i shpjegova për rininë tonë të atyre viteve, ajo më tha: Ju keni rini shumë të mirë, por do t'jua prishë televizioni, filmat, programet dhe ju nuk keni kulturën të kontrolloni televizionin për fëmijët, gjë që është e vërtetë.

Tek ne ende ndodh që në një sallon shohin së bashku filma apo emisione të rritur edhe fëmijë. Ka stacione televizive që bëjnë propagandën e një partie nga mëngjesi dei në darkë. Kaq shumë politikë në jetën e njerëzve nuk sjell asgjë të mirë për askënd.

***Cilët janë njerëzit që të kanë frymëzuar në jetë?***

Në radhë të parë motivimin kryesor e kam pasur nga im atë, megjithëse më ka vdekur i ri. Ai ka pasur shumë kulturë, me gjuhë të huaja si italisht, anglisht dhe arabisht, por nga ana tjetër vullnetin e madh dhe drejtësinë ma ka injektuar nëna ime. Ajo nuk na linte të abuzonim kurrë. Në punën me organizatat joqeveritare kam pasur shumë të bëj me Diana Çulin dhe Rolanda Dhimitrin, si dhe me plot të tjera. Në mënyrë të veçantë i jam mirënjohëse zonjës Alenka Verbole, e cila di jo vetëm sesi duhet punuar me gratë dhe se çfarë përgjegjësish të marrin përsipër, por edhe sesi të promovojë vlerat e grave, ajo di edhe të japë kurajo. Po kështu edhe zonja Ariana Haxhiu, që është shumë e veçantë në mënyrën sesi na përcjell informacionin dhe këshillat për mënyrën sesi ne duhet të arrijmë në ato nivele për të cilat konkurrojmë apo llobojmë. Mirënjohje për këto gra që japin kaq shumë për gratë.